MANUAL

PËR MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI

Tiranë, 2024

MANUAL PËR MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI

AKP - Agjencia Kombëtare e Pyjeve
Adresa: Rruga "Halit Bega", Godina Nr. 181, Tiranë,
www.akpyje.gov.al

CNVP - Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerëzit
Adresa: CNVP - Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerëzit
Zayed Business Centre, 7th Floor, Tirana.
www.cnvp-eu.org

Për hartimin e manualit *"Për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret"* kontribuuan:
Nga AKP-ja: ***Dr. Kliti Starja, Dr. Behar Hate, Bruno Ara***
Nga CNVP-ja: ***Janaq Male, Isuf Omuri***

Përgatitën për botim:
Specialistë të AKP-së: ***Mikel Nako, Hektor Xhomara***

Ky material u shërben: Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NjVV), Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, menaxherëve/pronarëve të pyjeve dhe kullotave, pylltarëve, organizatave (jo) qeveritare që kanë objektiv ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor, si dhe të gjithë banorëve në zonat rurale dhe qytete.

Shtypur në shtypshkronjën FILARA
website: www.filarabotime.com

PËRMBAJTJA

1 HYRJE 5
1.1 Kujt i shërben ky manual? 6
1.2 Kush mund ta përdorë këtë manual? 6
1.3 Grupet e synuara 7
1.4 Parathënie 7

2 DJEGIA 9
2.1 Mënyrat e transferimit të nxehtësisë 13

3 SHKAQET E SHFAQJES SË ZJARREVE NË PYJE/KULLOTA 16

4 KLASIFIKIMI I ZJARREVE TË PYJEVE/KULLOTAVE 18

5 MASAT MBROJTËSE KUNDËR ZJARREVE TË PYJEVE/KULLOTA 23
5.1 Masat parandaluese 23
5.2 Masat përgatitore 26
5.3 Masat direkte të lokalizimit dhe shuarjes 35

6 TAKTIKAT PËR LOKALIZIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE TË PYJEVE 40
6.1 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit nëntokësor 40
6.2 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit sipërfaqësor 41
6.3 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit të kombinuar 43

7 SKUADRA ZJARRFIKËSE 49
7.1 Pozicionimi i zjarrfikësve përgjatë vijës së pozitës mbrojtëse (pjesa e përparme e zjarrit) 49

8 ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË PARANDALIMIT/SHUARJES SË ZJARRIT NË NIVELIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE (NJVV, ADZM) LOKALE 52
8.1 Përfshirja e komunitetit në parandalimin e zjarreve në pyje 57

9 SIGURIA 58
9.1 Pajisjet mbrojtëse të zjarrfikësve 58
9.2 Këshilla të përgjithshme 59
9.3 Disa konsiderata të tjera 61
9.4 Planifikimi përpara 62

10 ANEKSE 64
10.1 Aneksi 1 Baza Ligjore 64
10.2 Aneksi 2 Patrulla e Parandalimit të Zjarrit në Pyje 73
10.3 Aneksi 3 Dhjetë urdhrat standard në rast zjarri 75
10.4 Aneksi 4 Largimi i komponentit të zjarrit dhe shuarja e tij 76
10.7 Aneksi 7 Si të vendosni alarmin e zjarrit në e-mailin tuaj (nga NASA) 82

1 HYRJE

Zjarret kanë qenë një problem i pranishëm në pyjet dhe kullotat e fermerëve dhe ne shpesh kemi parë njerëzit duke u munduar për t'i shuar ato. Ata përdorin metodat e tyre tradicionale të luftimit të zjarrit, por kjo nuk është e mjaftueshme në shumë raste. Për këtë arsye, fermerët duhet të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre, të përgatiten dhe pajisen me mjetet e nevojshme, si dhe të krijojnë e mirëmbajnë bashkëpunimin me komshinjtë dhe aktorët e tjerë të specializuar përpara se të ndodhin ngjarje të tilla, p.sh., rënia e zjarrit.

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, pyjet mbulojnë 31% të sipërfaqes së tokës në botë. Kjo përfshin mbi 4 miliardë hektarë të një ekosistemi jashtëzakonisht të çmuar, që përfshin biodiversitetin. Mbi gjysma e pyjeve të botës ndodhen në vetëm pesë vende: Brazili, Kanadaja, Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Federata Ruse. Që nga viti 1990, rreth 420 milionë hektarë pyje janë humbur. Shpyllëzimi, edhe pse është zvogëluar në dekadat e fundit, ai mbetet sërish një problem serioz. Pse? Këtu janë dhjetë efektet negative që shpyllëzimi ka mbi njerëzit dhe planetin:

Mbështetur në të dhënat e fundit në shkallë kombëtare (nga IKPK-ja Shqipëri), shpërndarja e territorit rezulton:

Pyll	1309767 ha	(45.6%),
Kullota	547682 ha	(19.1%),
Zona urbane	66337 ha	(2.3%),
Sipërfaqe ujore	78013 ha	(2.7%),
Toka bujqësore	702646 ha	(24.4%),
Të tjera	170355 ha	(5.9%).
Totali	**2874800 ha**	

Zjarret e rëna në pyje dhe kullota kanë një ndikim të pallogaritshëm në pasojat negative që rrjedhin nga djegia e tyre.

Gjatë periudhës së tranzicionit, zjarret kanë qenë të pranishme në pyjet dhe kullotat e menaxhuara nga NjVV-ja, të AdZM-së dhe të fermerëve privatë. Në shumë

raste, për vënien nën kontroll të janë përdorur mënyrat tradicionale të luftimit të zjarrit, por kjo nuk është e mjaftueshme.

Duhet të rrisim njohuritë dhe aftësitë e strukturave, të sigurojmë pajisjet e nevojshme, të forcojmë bashkëpunimin me aktorët e tjerë të specializuar përpara se të ndodhë një ngjarje e tillë (rënia e zjarrit dhe shuarja e tij).

Qëllimi i këtij manuali është të ndihmojë trajnerët, menaxherët dhe specialistët që punojnë në sektorin e pyjeve pranë NjVV-së, AdZM-së, përdoruesit/pronarët e pyjeve për të kuptuar më mirë dhe për të reaguar në mënyrën e duhur për të parandaluar, lokalizuar, luftuar dhe shuar një zjarr që ka rënë në pyllin/kullotën e menaxhuar prej tyre.

Manuali për parandalimin e zjarreve pyjore është përgatitur në bazë të problematikave të vërejtura gjatë parandalimit, shkuarjes në vendin e zjarrit, shuarjes së tij dhe nevojës për t'i kushtuar vëmendjen e duhur parandalimit të zjarreve në pyje/kullota.

1.1 Kujt i shërben ky manual?

Ky manual është përgatitur për t'u ardhur në ndihmë të gjithë trajnerëve që do të trajnojnë individë të përfshirë në Administrimin dhe Menaxhimin e Pyjeve dhe Kullotave (burra dhe gra).

1.2 Kush mund ta përdorë këtë manual?

Ky manual është hartuar për t'i ofruar trajnerëve njohuritë dhe praktikat që duhet të përdorin për të trajnuar të gjithë individët që do të angazhohen direkt ose indirekt në zjarret që mund të shfaqen në pyje dhe kullota.

Manuali mund të përdoret nga:

- Të gjithë individët, organizatat (jo) shtetërore, të ngarkuar me parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje/kullota.
- Menxherët/pronarët të cilët janë të parët që duhet të kontribuojnë në marrjen e të gjitha masave të mundshme për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit. Ata janë personat e parë që vrapojnë për të kufizuar dhe shuar atë.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NjVV), struktura e AdZM-së dhe pronarët e pyjeve/kullotave duhet të hartojnë planet për parandalimin/mbrojtjen/shuarjen e zjarreve dhe të krijojnë e mbajnë kontaktet me grupet/ekipet e zjarrfikësve.
- Pylltarët, si personat më të kualifikuar në pylltari dhe të obliguar me ligj (ata që punojnë për pronarët/përdoruesit e pyjeve), duhet të përgatisin planin e

parandalimit dhe të përfshijnë të gjithë aktorët e përfshirë menaxhimin e situatës së zjarrit.

- Forcat e specializuara në nivel qarku/bashkie (Forcat e Mbrojtjes nga Zjarri).

1.3 Grupet e synuara

2. Menaxherët e pyjeve (NjVV, AdZM, Pronarët/përdoruesit)
3. Konsulentët privatë të pyjeve
4. Specialistët e pyjeve dhe kullotave
5. OJQ-të, Federatat e përdorimit të pyjeve, Federata Mjedisore etj.

1.4 Parathënie

Pylli ka nevojë që njerëzit ta mbrojnë dhe ta zhvillojnë atë.

Zjarret e pyjeve janë një nga faktorët kryesorë që dëmtojnë ose shkatërrojnë zona të mëdha të pyjeve dhe kullotave në një periudhë shumë të shkurtër kohe. Shumë dëme të drejtpërdrejta që shkaktohen nga zjarri janë: dru të djegur, infrastrukturë e dëmtuar (linjat e energjisë elektrike) shpenzimet për lokalizimin dhe shuarjen etj. Gjithashtu, ka edhe dëme indirekte, si: erozioni i tokës, sëmundjet (drurët e vdekur shtojnë insektet që jetojnë nën lëkurën e drurit). Shpesh, insektet që jetojnë nën lëvoren e drurëve të llojeve halorë në zonat e prekura nga zjarri mund të paraqesin një problem më të madh dhe më të gjatë në kohë sesa vetë zjarri). Kjo sjell humbje ekonomike, mjedisore, si dhe të vlerave sociale (rekreative) të pyjeve.

Zjarri mund të jetë shkaku kryesor i degradimit të ekosistemit

Përdorimi i pakujdesshëm apo kriminal i zjarrit ka një ndikim katastrofik. Zjarri mund të jetë shkaku kryesor i degradimit të ekosistemit dhe mund të shkaktojë humbje të jetës njerëzore, rrënim ekonomik, përçarje sociale dhe dëme mjedisore. Çdo vit, zjarret dëmtojnë miliona hektarë pyje të lëndës drusore të vlefshme, produkte të tjera pyjore dhe shërbime mjedisore e turistike që ofrojnë ekosistemet pyjore.

Efekti i humbjeve ekonomike dhe dëmtimi total i shkaktuar nga zjarret në pyje do të ndikojë te njerëzit dhe në vend si tërësi. Kjo është arsyeja bazë për organizimin e menaxhimit të zjarrit në pyje.

Vlerësimi i humbjeve reale dhe totale nuk është i thjeshtë. Në shtesë të pyllit të djegur (që mund të llogaritet lehtë në para), mund të ndodhin shumë lloje të tjera humbjeje. Humbja totale e shkaktuar nga zjarret mund të njihet vetem disa vite më vonë, për shembull, në lidhje me erozionin e tokës dhe dëmet që pasojnë

nga erozioni i tokës. Vlerësimi i dëmit të shkaktuar nga zjarri në rastin e burimeve rekreative është një shembull ekstremisht i vështirë.

Humbja e jetës së njeriut për shkak të një zjarri në pyll nuk është një ndodhi e përditshme, por a është kaq e rrallë sa të konsiderohet e papërfillshme?

Shpenzimi i burimeve financiare nga njëra anë për mbajtjen nën kontroll të zjarreve, ndërkohë që të mirat materiale konsumohen nga zjarri.

Humbja e shtëpive, ndërtesave të tjera, rrugëve, tokës së fermave dhe të tilla si këto duhet t'i shtohen vlerës totale të humbjes.

Cenueshmëria është përcaktuar si masë të cilën një sistem natyror ose shoqëror është i prirur të dëmtohet kur ekspozohet ndaj një rreziku të caktuar. Në këtë kontekst, zjarret në pyje janë rreziqe natyrore që vazhdimisht ndikojnë në evoluimin e sistemit përreth, atij lokal, natyror dhe shoqëror.

Ndikimi në ndryshimet klimatike

Zjarret në pyje paraqesin një problem të madh dhe kompleks, i cila është përtej marrëdhënies së thjeshtë me klimën, duke çuar në shumë pasoja mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Humbja e habitateve, erozioni i tokës dhe emetimet e CO_2 janë shembuj të pasojave ekologjike, ndërsa ndikimi në shëndetin e njeriut, aktivitetet bujqësore dhe turistike, si dhe tregu rajonal i punës janë shembuj të efekteve sociale, ekonomike dhe ekologjike.

Ky fakt kjo nënkupton se parandalimi i zjarrit në pyje kërkon më shumë vëmendje.

Kapacitetet e të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë (qeveritare dhe joqeveritare, profesionale dhe vullnetare) duhet të ndërtohen/krijohen. Zjarret nuk njohin kufij mes shteteve, midis qarqeve dhe bashkive, as kufijtë midis pronës shtetërore dhe private.

2 DJEGIA

Së pari, duhet të kemi të njëjtin perceptim për atë që quhet "*Djegie*".

Në shekullin XVIII, me zhvillimin e parimeve të fizikës të pathyeshmërisë së materies (lëndës), Lavoisier arriti në përfundimin se djegia është një reaksion kimik, në të cilin oksigjeni bashkohet me lëndën djegëse. Procesi kimik i lidhjes së oksigjenit me lëndë të tjera njihet si oksidim, dhe prodhimet e saj janë quajtur okside. Në praninë e nxehtësisë çlirohet oksidi. Oksigjeni lidhet lehtë me lëndë të tjera dhe oksidimi është një ngjarje shumë e zakonshme në natyrë.

Djegia është një reaksion kimik i shpejtë dhe eksploziv, i shoqëruar me flakë të lehta dhe me çlirimin e një sasie të madhe energjie (temperaturë të lartë).

Bazuar në gjendjen e oksidantit dhe lëndës djegëse, ka dy lloje të djegieve: 1. Homogjene; 2. heterogjene.

1. Djegia homogjene ndodh kur gjendja agregate e lëndës së djegshme është një gaz.

Kjo lloj djegieje ndodh vetëm kur ekziston një raport i caktuar mes oksidantit dhe lëndës djegëse. Kur raporti nuk është i balancuar në kushte ku prania e oksigjenit apo e lëndës djegëse ndryshon, edhe në qoftë se këto dy elemente janë në sasi të mëdha, nuk ndodh djegia.

2. Djegia heterogjene ndodh kur oksigjeni lidhet me një lëndë djegëse që është e ngurtë ose e lëngshme.

Kjo lloj djegieje, për dallim nga ajo homogjene, mund të ndodhë në çdo porcion të lëndës djegëse. Në këtë rast, shpejtësia e djegies varet nga sasia e oksigjenit, d.m.th.: sa më i shpejtë është furnizimi me oksigjen, aq më e shpejtë është djegia.

Siç është përmendur tashmë, djegia është një reaksion kimik i shoqëruar nga flaka, gjatë së cilës çlirohet nxehtësi dhe tym.

Djegia nuk mund të ndodhë nëse këto tri elemente nuk janë të pranishme:

a) lënda djegëse;
b) oksidanti (O2 - oksigjeni);
c) nxehtësia/burimi i nxehtësisë.

Trajneri duhet të shpjegojë se çfarë është secili prej këtyre tri elementeve, rolin që

ka secili prej tyre në procesin e djegies, si dhe të përfshijë pjesëmarrësit në diskutime gjatë trajnimit.

Duke analizuar këto tri elemente, *Obsborn* arriti në përfundimin se të tria janë njësoj të rëndësishme për procesin e djegies. Kjo do të thotë se djegia do të ndalojë në rast se ndonjë prej tyre eliminohet (Vizatim 1).



Vizatim 1: Trekëndëshi i zjarrit

a) ***Lënda djegëse***

Lënda e krijuar, qoftë natyrale ose artificiale, e cila mund të ndizet dhe digjet, quhet lëndë djegëse. Lënda djegëse mund të jetë: e ngurtë, e lëngshme ose gaz.

P.sh., qymyri, druri, plastika, goma, produktet tekstile etj., konsiderohen lëndë djegëse të ngurta.

Lënda djegëse e ngurtë ka një proces kompleks të djegies. Domethënë, shpejtësia e djegies nuk varet vetëm nga furnizimi me oksigjen, por edhe nga shpejtësia e oksigjenit kombinuar me sipërfaqen specifike të lëndës djegëse.

Materiali i përbërë nga grimcat e vogla të pluhurit, i quajtur pluhur shpërthyes, konsiderohet gjithashtu lëndë djegëse e ngurtë. Materiale të tilla janë: zinku, alumini, magnezi, qymyri, squfuri, sheqeri, mielli, tallashi etj. Kjo lloj lënde djegëse e ngurtë, në rrethana të caktuara, mund të krijojë një përzierje eksplozive. Një shpërthim mund të ndodhë nëse ajri përmban sasi të mjaftueshme të këtij pluhuri me madhësi të caktuara grimcash, në kontakt me një burim nxehjeje.

Gjithashtu, lëndët djegëse mund të jenë të lëngshme. Tipike për këtë lloj lënde djegëse është se ato nuk digjen kur ndodhen në formë të lëngshme.. Procesi i djegies, në këtë rast, ndodh kur ato nën efektin e burimit të nxehtësisë, avullojnë pak nga sasia e saj e lëngshme dhe materiali digjet në kombinim me ajrin. Kjo do të thotë se djegia e lëndëve të lëngshme ndodh në sipërfaqen e tyre kur gazet e avulluara përzihen me ajrin (oksigjenin).

Djegia e lëndëve djegëse të gazta është forma më e thjeshtë e djegies, e njohur si djegie homogjene. Kjo kërkon që lënda djegëse gaz të jetë në një përzierje të caktuar me ajrin dhe të ketë kontakt me burimin e nxehtësisë për të mundësuar fillimin e procesit të djegies.

Djegiet shpërthyese mund të ndodhin kur e gjithë sasia e gazit (lënda djegëse) ndodhet në një përzierje të caktuar me oksigjen.

Lëndët djegëse do të ndikojnë direkt në sjelljen e zjarrit bazuar në të dhënat e tyre, si:

- Klasa;
- Lloji;
- Madhësia dhe Sasia;
- Vendosja/Shtrirja;
- Përmbajtja e lagështisë.

Klasa e Lëndës djegëse sipas llojit

a. Lëndë djegëse tokësore janë materialet që ndodhen nën sipërfaqen e mbeturinave organike, duke përfshirë rrënjët, torfet, ose materiale të tjera organike të varrosura. Sjellja e zjarrit në këtë klasë është e kufizuar, sepse lënda djegëse digjet në vetvete ose djegia ndodh me intensitet shumë të ulët, por mund të jetë e qëndrueshme për ditë, javë apo edhe muaj.

b. Lëndë djegëse sipërfaqësore janë vegjetacioni i djegshëm që ndodhet mes lëndëve djegëse tokësore dhe lëndëve djegëse të kurorës. Shembuj të këtij lloji të lëndëve djegëse përfshijnë trungjet dhe degët e vdekura, shkurret, barin, shqopën, drurët e rinj, filizërinë etj. Lëndët djegëse sipërfaqësore gjithmonë do të luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e intensitetit dhe shkallës së përhapjes së zjarrit.

c. Lëndë djegëse të kurorës janë lëndët djegëse që ndoshen në këmbë dhe të mbështetura që nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën. Kjo klasë do të përfshijë lëndë djegëse të degëve dhe nivelet e sipërme të pyjeve dhe kurorave të

drurëve apo shkurreve. Intensiteti i zjarrit në këto raste duhet të jetë ekstrem, në mënyrë që zjarri të arrijë dhe të përhapet përmes lëndëve të djegshme të kurorës.

Madhësia dhe sasia

Ka dy kategori kryesore të lëndëve djegëse:

a. Lëndë djegëse të imëta janë lëndët djegëse të vogla, si lëgusha, bari apo gjethet. Këto lëndë djegëse janë të thata dhe shumë të ndezshme. Ato shpesh kanë ndikim kryesor në intensitetin dhe shkallën e përhapjes së zjarrit.

b. Lëndët djegëse të rënda ose të trasha përfshijnë trungjet ose degët e mëdha në diametër. Këto lëndë djegëse shpesh vazhdojnë të digjen për një kohë gjatë, pasi zjarri kalon mbi to.

Sasia e lëndëve djegëse të disponueshme për t'u djegur ndikon drejtpërdrejt në intensitetin dhe normën e përhapjes së zjarrit. Një sasi e madhe e lëndëve djegëse të imëta stimulon sjelljen e fortë të zjarrit në krye të flakës, ndërsa një sasi e madhe lëndësh djegëse të rënda do të rezultojë në një zjarr me intensitet të ulët, i cili do të vazhdojë të digjet për një kohë të gjatë pas kalimit të flakës së parë.

Vendosja/Shtrirja

Gjatë djegies, rëndësi të madhe ka vendosja apo shtrirja e lëndës djegëse, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht.

a. Imagjinoni një pyll me lloje të ndryshme drurësh dhe copëra drurësh në distanca të afërta dhe të largëta nga njëri-tjetri - kjo është **vendosja/shtrirja horizontale.** Lëndët djegëse të veçuara do të digjen me një intensitet relativisht të ulët, ndërsa një sasi e madhe materiali të grumbulluar *(por jo të ngjeshur)* do të digjet me një intensitet të lartë.

b. Vendosja/shtrirja vertikale ka të bëjë me sasinë dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse nga niveli i lëndëve djegëse tokësore deri në nivelin e lëndëve djegëse të kurorave.

Përmbajtja lagështisë n*ë lëndët djegëse*

Sasia e lagështirës së ruajtur brenda një pjese të vegjetacionit do të ndikojë në sa lehtë do të digjet dhe me çfarë intensiteti ajo do të digjet. Faktorët mjedisorë që ndikojnë në lagështinë e lëndës djegëse janë: *lagështia relative, reshjet, temperatura e ajrit* dhe, në një shkallë më të vogël, *hija, kundrejtimi, pamja, lartësia mbi nivelin e detit* etj.

Një lëndë djegëse me përmbajtje të lartë lagështie, si rezultat i një shiu të fundit, lagështisë së lartë apo afërsisë me një burim uji, do të digjet me vështirësi (rrezik më i vogël djegieje). Lëndët djegëse me përmbajtje të ulët lagështie do të digjen më lehtë, me një intensitet të lartë dhe me një normë të shpejtë përhapjeje.

b. Oksigjeni (O_2) – oksidant (ajrosja)

Oksigjeni është një nga tri elementet e nevojshme për të nisur procesi i djegies. Djegia është një proces në të cilin oksigjeni bashkohet me lëndën djegëse.

Oksigjeni është një gaz i lirë që përbën 20.95% të atmosferës, por është gjithashtu i pranishëm në natyrë, i lidhur me elemente të tjera (në ujë, vegjetacion dhe shumë lëndë të tjera). Lidhja bëhet edhe më shumë intensive kur procesi ndodh në temperatura të larta, sidomos gjatë djegies.

Kjo do të thotë se, nëse furnizimi me oksigjen rritet, djegia do të bëhet gjithnjë e më intensive për shkak të rritjes së lëshimit të energjisë dhe nxehësisë. Ky fenomen është i njohur prej kohësh për njerëzit dhe ka gjetur përdorim në shumë fusha të teknikës, si për shembull në farkëtim për të nxitur djegien e qymyrit në mënyrë që të arrijnë temperatura më të larta.

Nga ana tjetër, nëse reduktohet furnizimi me oksigjen në zonën e djegies, intensiteti i djegies do të ulet. Në qoftë se sasia e oksigjenit në zonën e djegies është reduktuar me 16% apo më poshtë, djegia do të ndalet d.m.th.: zjarri shuhet, për shembull, nëse një qiri i ndezur është vendosur nën një enë qelqi (ose tjetër enë të mbyllur hermetikisht), ai do të digjet derisa oksigjeni brenda në enë të reduktohet në 16% ose më poshtë dhe pastaj do të shuhej.

c. Burimi i nxehtësisë

Për të filluar procesin e djegies, nuk është e mjaftueshme vetëm prezenca e oksigjenit dhe e lëndës djegëse, por gjithashtu është e nevojshme edhe prania e një burimi nxehtësie. Burimi i nxehtësisë mund të ketë origjinë të ndryshme, të tilla si ndodhitë natyrore *(rrufeja, shpërthimet vullkanike, reaksionet kimike etj.),* por ajo gjithashtu mund të jetë një rezultat i veprimtarisë njerëzore.

Vetëdjegia, që ndodh për shkak të rrezeve të forta të diellit dhe reaksioneve biokimike në lëndën djegëse, rrallëherë është një arsye për zjarret e pyjeve. Gati asnjëherë nuk është arsyeja që shkakton zjarret në pyje/kullota.

Mundësia e vetëdjegies është deri tani më e lartë në bujqësi, ku gjendet bari i thatë apo kashta, ose në industrinë e drurit ku gjendet tallashi apo lëndë djegëse të tjera lehtësisht të ndezshme.

Aktivitete të ndryshme të njeriut janë shkaku kryesor ose bazë (direkt apo indirekt) i zjarrit në pyje e kullota.

2.1 Mënyrat e transferimit të nxehtësisë

Pasi analizuam se "çfarë është djegia" dhe elementet që e bëjnë djegien të ndodhë, duhet të shpjegojmë mënyrat/rrugët e transferimit të nxehtësisë. Fotot e prezantuara tregojnë mënyra të ndryshme të transferimit të nxehtësisë.

Në rastet kur të tria elementet e nevojshme për djegien (oksigjeni, lëndët djegëse dhe burimi i nxehtësisë) janë të **pranishme, djegia nuk mund fillojë pa u transferuar nxehtësia te** lënda djegëse.

Nxehtësia mund të transferohet te lënda djegëse në disa mënyra/rrugë: *rrezatimi, përçueshmëria, fërkimit (mekanik)* ose përmes një reaksioni biokimik.

Energjia e nxehtësisë transferohet nga **rrezatimi** kur burimi i nxehtësisë dhe lënda djegëse nuk janë në kontakt, p.sh., janë të vendosur në një distancë të caktuar. Fuqia e rrezatimit do të varet nga shkalla në të cilën rrezatuesi është nxehur, madhësia dhe forma e tij, materiali nga i cili është bërë etj.

Transferimi i nxehtësisë nga **përçueshmëria** është një tipar i objekteve (materialeve) të ngurta. Domethënë, nxehtësia transferohet nga fundi i një objekti tek objekti tjetri në rast se dy trupat (objektet) janë në kontakt.

Objektet (trupat) ndahen në përçues të mirë dhe të keq të nxehtësisë. Për shembull, nëse mbajmë një shkop prej druri dhe një prej metali, dhe në të njëjtën kohë vendosim fundin e secilit në zjarr, ne mund të vazhdojmë të mbajmë shufrën e drurit, edhe pse ajo ka marrë zjarr, derisa zjarri të arrijë shumë afër dorës me të cilën ne po e mbajmë, ndërsa shufrën e metalit do ta lëshonim shumë shpejt, për shkak të përcjelljes së shpejtë të nxehtësisë nga njëri skaj në tjetrin.

Ky shembull tregon se metalet janë përçues të mirë të nxehtësisë, ndërsa druri është një përçues i dobët. Ajri dhe materialet që janë të përhapur lehtë (bari) janë gjithashtu përçues të këqij të nxehtësisë.



Transferimi i nxehtësisë

Transferimi i nxehtësisë nga **qarkullimi** apo lëvizja është një tipar i materialeve të lëngshme dhe të gazta. Para së gjithash, shtresat të cilat janë më afër burimit të nxehtësisën ngrohen dhe transferohen nga shtresat më të ngrohta, në shtresat e ftohta. Për shembull, shtresa e ajrit afër tokës është e nxehtë nga sipërfaqja e tokës, ajo pastaj bëhet e lehtë dhe ngjitet lart, dhe ajri i ftohtë që është më i rëndë, bie poshtë nga shtresat e sipërme. Ky fenomen çon në lëvizjen e masave të ajrit. Një tjetër shembull mund të jetë ai i një ene qelqi të mbushur me ujë e të vendosur në një burim nxehtësie (sobë). Në një kohë të shkurtër ju do të vini re lëvizjen e ujit nga fundi i enës drejt sipërfaqes së ujit (uji i nxehtë është më i lehtë dhe lëviz lart), kurse uji që lëviz nga shtresat e sipërme poshtë (uji i ftohtë ka peshë specifike më të rëndë dhe lëviz poshtë).

Transferimi apo krijimi i nxehtësisë nga **fërkimi** ndodh kur dy trupa fërkohen me njëri-tjetrin me një shpejtësi të caktuar. Njerëzit e kanë njohur këtë fakt që në kohët parahistorike dhe, në fakt, kjo tregon se si ata ndezën zjarrin.

Si rezultat i **reagimeve biokimike të caktuara** të brendshme, brenda vetë lëndës djegëse, çlirohet një nxehtësi që nxeh materialin deri në pikën e vetëpërçueshmërisë. Kjo lloj djegieje ndodh me llojet e lëndëve djegëse të imëta (bari, tallash, qymyr etj.).

Niveli/temperatura e vetëpërçueshmërisë është e ndryshme për materiale të ndryshme.

3 SHKAQET E SHFAQJES SË ZJARREVE NË PYJE/KULLOTA

Njohuritë dhe përvoja jonë e deritanishme tregon se në shumicën e rasteve shkaku i zjarrit në pyje dhe kullota (direkt ose indirekt), **është njerëzor.**

Goditja nga rrufeja dhe vetëdjegia nuk konsiderohen apo janë shumë të rralla si shkaqe për zjarret e shkaktuara në pyjeve.

Njerëzit shkaktojnë zjarre në pyje si shkak i pakujdesisë, injorancës, lakmisë, diversionit, sëmundjes se zjarrvënies (piromanisë) e të tjera.

- ***Në kategorinë e zjarreve të shkaktuara nga pakujdesia dhe injoranca hyjnë zjarret e shkaktuara nga:***
  a. Punëtorët, kur janë duke kryer operacione të caktuara pyjore apo bujqësore në pyje apo sipërfaqe pyjore/kullosore. Zjarre të tilla zakonisht ndodhin në pranverën e hershme (puna në terren, pyllëzim) kur bari i vitit të kaluar është tharë dhe bimësia tjetër nuk ka filluar akoma ciklin e vegjetacionit.

Vendosja e zjarrit në hamullore është rasti më i zakonshëm i zjarrit të shkaktuar nga pakujdesia dhe kjo mënyrë e pastrimit të bimëve të padëshiruara nga fermeri, është e ndaluar.

  b. Mbledhësit e frutave të pyjeve dhe bimëve mjekësore, gjahtarët dhe peshkatarët, blegtorët dhe turistët.
  c. Zjarret e shkaktuara nga objektet në pyje (hekurudha dhe rruga për transport publik, linjat e transmetimit të tensionit të lartë etj.).

Numri i zjarreve në zonat e hapura është i madh për shkak të mungesës së masave parandaluese në kohë (pastrimit të zonës përreth, skajeve/anëve të rrugëve dhe të ngjashme me këto) rreth objekteve të përmendura.

- ***Në kategorinë e zjarreve shkaktuar nga lakmia dhe diversioni janë zjarret e shkaktuara në pyje me qëllim të caktuar:***
  a. Me qëllim shtimin e tokave bujqësore apo kullosore, urbane, njerëzit i djegin pyjet pa marrë parasysh pasojat e një akti të tillë.
  b. Në kushte të përshtatshme atmosferike, disa njerëz qëllimisht u vënë zjarrin sipërfaqeve pyjore, si hakmarrje ndaj pylltarëve.
  c. Pyjeve gjithashtu mund t'iu vihet zjarri qëllimisht për arsye politike, p.sh.: për të destabilizuar vendin me një numër të madh të zjarreve në pyje e kullota.

- ***Kategoria e zjarreve të shkaktuara nga mungesa e ndërgjegjësimit dhe sëmundja e zjarrvënies përfshin:***
  a. Zjarret e shkaktuara nga lojërat e fëmijëve me zjarrin (fëmijët janë të pavetëdijshëm që lojëra të tilla mund të shkaktojnë zjarre dhe të jenë fatale për ta).
  b. Zjarret e shkaktuara nga njerëzit e sëmurë "piromanët" për të cilët vënia e zjarrit objekteve ose sipërfaqeve me pyje dhe shikimi (parja) e tyre duke u djegur *"u jep atyre një kënaqësi të madhe"*.

- ***Zjarret që ndodhin gjatë luftës*** konsiderohen një kategori e ndarë. Këto zjarre nuk klasifikohen në asnjërën nga kategoritë e listuara më lart.

a)

a) hedhja e një cigareje përfundon si shkak i zjarrit

b)

b) lojërat e fëmijëve si shkak i zjarrit



Djegia e kashtës (hamullores) si shkak i zjarrit

4 KLASIFIKIMI I ZJARREVE TË PYJEVE/KULLOTAVE

Në bazë të përvojave ndër vite, njihen apo klasifikojmë 4 lloje të zjarreve në pyje dhe kullota, me të cilat duhet të njihemi paraprakisht dhe të jepen sqarimet dhe shpjegimet përkatëse nga trajnerët apo menaxherët e zjarreve në pyje dhe kullota.

Cilat janë ato?

Zjarrfikësit e shuarjes së zjarreve, punonjësit në pyje, por dhe vullnetarët, duhet të dinë karakteristikat e zjarreve në pyje para se të përpiqen për t'i lokalizuar dhe shuar ato. Rëndësia e njohjes së tyre qëndron në faktin e menaxhimit më të mirë të burimeve dhe përpjekjeve për të lokalizuar dhe shuar zjarrin.

Kjo, gjithashtu, do të ndihmojë zjarrfikësit për të përgatitur dhe për të mbrojtur më mirë veten nga një aksident i mundshëm. Pas shpjegimit të tyre, çdo pjesëmarrës mund të japë shembuj nga eksperienca e tij/saj (nëse ata kanë).

Ekzistojnë disa klasifikime të zjarreve në pyje/kullota, por më i shpeshtë është klasifikimi sipas zonës së djegies aktive:

a) **Zjarri nëntokësor;**
b) **Zjarri sipërfaqësor;**
c) **Zjarri i kurorave;**
d) **Zjarri i kombinuar.**

a) ***Zjarri nëntokësor***

Karakteristikë e këtij lloj zjarri është se procesi i djegies ndodh nën shtresat e trasha të lëgushës, myshkut, gjetheve të pakalbura etj. Zjarri përhapet gradualisht dhe tymi i çliruar mbush hapësirat midis materialeve djegëse dhe del në sipërfaqe pa u vënë re, me përjashtim të rasteve kur takon rrënjët e ndonjë cungu, të cilët veprojnë si oxhak dhe tymi del në sipërfaqe më intesivisht.

Vënia re e këtyre zjarreve është e vështirë. Si rezultat, zjarre të tilla shpesh nënvlerësohen, por ato vërehen nga fakti që bimësia mbi këto sipërfaqe thahet.

b) Zjarri sipërfaqësor

Zjarri sipërfaqësor konsiderohet një zjarr gjatë së cilit ekziston djegia aktive në sipërfaqen e tokës, p.sh.: bimësia e tokës është duke u djegur apo gjethet me degë të vogla që kanë rënë, boçet etj. Ky është një ndër zjarret më të shpeshtë

dhe shkakton tipe të tjera zjarresh (zjarret e kombinuara apo ato të kurorave të drurëve).

Në varësi nga konfiguracioni i terrenit dhe shpërndarja e lëndës djegëse, ky lloj zjarri përhapet shumë shpejt. Përbën problem serioz për sa i takon lokalizimit dhe shuarjes së tij.

Bazuar në kushtet e përmendura më lart dhe në mungesën apo prezencën e erës, flakët në këtë lloj zjarri mund të arrijnë lartësinë deri në 1.5 m dhe më shumë. Në rrafshina, djegia intensive zakonisht ndodh në skaje të zjarrit, ndërsa në zona malore djegia ndodh në ballë të zjarrit. Shpejtësia me të cilën përhapet ky zjarr (pa erë të fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

a) Zjarri nëntokësor



b) Zjarri sipërfaqësor

c) ***Zjarri i kurorave (të drurëve)***

Zjarri në kurorat e drurëve është lloji i zjarrit gjatë të cilit ndodh djegia në kurorat e drurëve. Në shumicën e rasteve, zjarri është në trungje individuale, por ka edhe raste kur një zonë më e madhe është në zjarr. Zjarri, ndonjëherë në tokat kënetore/moçalore ose në rastin me erëra shumë të forta, thjesht "fluturon" përmes kurorave të drurëve pa zbritur në tokë.

Në raste të tilla, për shkak të shpejtësisë së lartë, djegie të plotë pësojnë gjethet, kurse degët mbeten vetëm "gjysmë të djegura". Ky lloj i zjarrit mund të ndodhë, gjithashtu, si një fazë e një zjarri të kombinuar kur vetëm kurorat e drurëve janë djegur. Për shkak të faktit se intensiteti i djegies është në degët e pasura me gjethe

(për pasojë edhe lagështia është më e lartë), ka më shumë tym dhe flakë. Shpejtësia e përhapjes është e lartë dhe ndodh si hedhje eksplozivi - flakë më e gjatë.

Drurët me kurora që takohen ose janë afër njëri-tjetrit rrisin probabilitetin e përhapjes së zjarrit përmes kurorave.

Në pyjet kur zjarri është një rrezik i lartë, duhet të hiqen/priten mjaftueshëm drurë në mënyrë që **dy kurora drurësh** të jenë të paktën 3 metra larg nga njëra-tjetra. Në shpatet më të thepisura se 20% pjerrësi, hapësira midis kurorave duhet të jetë më e madhe.

Drurët bashkëshoqërues (që rriten nën kurorat e grumbullit parësor) sigurojnë një "shkallë, mundësi kalimi" për zjarrin, për të lëvizur nga toka në kurorat e drurëve më të mëdhenj. Drurët më të vegjël formojnë një lloj shkalle për konfigurimin, i cili kontribuon që zjarri të përhapet në kurorat e drurëve më të mëdhenj.



a) Zjarri në kurorat e drurëve

b) Zjarri i kombinuar

d) ***Zjarri i kombinuar***

Zjarret gjatë së cilëve lënda djegëse tokësore dhe kurorat e drurëve digjen në të njëjtën kohë quhet zjarr i kombinuar. Për shkak të kësaj veçorie, këto zjarre janë më të vështirat për t'u lokalizuar dhe shuar.

Shpejtësia e përhapjes së këtyre zjarreve varet nga konfiguracioni i terrenit, llojet dhe shpërndarja (vertikale dhe horizontale) e lëndës djegës. Gjithashtu, shpejtësia e erës luan një rol vendimtar në përhapjen e zjarrit që mund të arrijë deri në 10 km/h.

Përhapja e zjarrit të kombinuar kalon në tri faza: **faza përgatitore, kërcimi i zjarrit dhe faza qetësuese.**

Faza përgatitore: është kur zjarri ka arritur në kurorat e drurëve dhe than dhe djeg gjethet. Gjatë kësaj djegieje, nxehtësia e çliruar akumulohet në kurorat e drurëve dhe formon një rrymë nxehtësie mbi kurorat e tyre. Kjo rrymë përbëhet nga ajri i nxehtë, tymi dhe pjesëzat e tjera (pjesëzat e drunjve pjesërisht të djegura, shkëndijat, copat e vogla të gjetheve etj). Kjo nxehtësi e akumuluar në kurorat e trungjeve dhe rrymat qarkulluese rrezatojnë dhe, në këtë mënyrë, ngrohin dhe thajnë kurorat e drurëve në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Kur një sasi e mjaftueshme e lëndëve djegëse të gazta të avulluara është akumuluar në kurorat e drurëve në zonën përpara zjarrit, në një pikë të caktuar në rast të djegies intensive përballë zjarrit, gazet në kurorat e drurëve ndizen në zonën përballë zjarrit.

Kjo ndezje mund të ndodhë në distanca të ndryshme nga pjesa e përparme e zjarrit dhe quhet **kërcim i zjarrit**. Kjo është faza e dytë e përhapjes së zjarrit dhe kërcimi mund të ndodhë, madje, edhe në disa dhjetëra metra para pjesës së përparme të zjarrit.

Kjo shkakton një tjetër zjarr në zonën para pjesës së përparme të zjarrit.

Pastaj vjen një **fazë qetësuese;** gjatë kësaj faze zjarri "kryesor" lëviz drejt zjarrit të ri, i cili zbret nga ***kurora e trungjeve*** në tokë. Në këto momente kemi përshtypjen se zjarri është qetësuar, por në fakt është faza e parë përgatitore e një kërcimi të ri të zjarrit që është duke ndodhur këtu tashmë.

Zjarrfikësit duhet të njohin mirë këtë përhapje të zjarrit në mënyrë që t'i shmangen rrezikut të të zënit midis dy zjarreve kur ka kërcim të zjarrit dhe kur jeta e tyre vihet ne rrezik.

Në rast të zjarreve tokësore apo të kombinuara, pjesët vijuese mund të klasifikohen në vendndodhjen e zjarrit: pjesa e prapme e zjarrit, pjesët anësore të zjarrit, pjesët e gjurmëve apo rrezeve, hendeqet e zjarrit, pjesa e përparme e zjarrit dhe shkëndijat (zjarret e reja).



Pjesët përbërëse të zjarrit

- Pjesa e prapme e zjarrit është vendi i zjarrit ku djegia ka intensitetin më të ulët dhe shpejtësinë më të ngadaltë të përhapjes.
- Pjesa anësore e zjarrit është vija e djegies që ka intensitetin më të fortë dhe shpejtësinë e përhapjes më të madhe krahasuar me pjesën e prapme të zjarrit, por nuk është drejtimi kryesor në të cilin përhapet zjarri.
- Gishtat apo rrezet e zjarrit janë pjesë të përparme të zjarrit. Ato formohen si rezultat i faktit që pjesa e përparme e zjarrit arrin në zonat ku nuk ka lëndë djegëse apo ku lënda djegëse digjet me intensitet më të ulët. Rrezet më vonë mund të bashkohen me pjesën e përparme të zjarrit duke formuar një linjë apo mund të vazhdojnë në një drejtim tjetër duke krijuar kështu linja të reja përpara zjarrit.
- Zonat midis rrezeve të zjarrit quhen xhepa të zjarrit. Ato janë tepër të rrezikshme, pasi zjarrfikësit apo njerëz të tjerë mund të zihen aty, pa qenë në dijeni që janë të rrethuar nga zjarri.
- Pjesa e përparme e zjarrit është linja e djegies më intensive. Ai është drejtimi kryesor i zjarrit.
- Ishulli apo zjarri i ri është vend i nxehtë i ri, në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Mund të krijohet nga një kërcim zjarri, boçe e djegur, gjethe e djegur etj.

5 MASAT MBROJTËSE KUNDËR ZJARREVE TË PYJEVE/KULLOTA

Hapi i parë vendimtar në menaxhimin e zjarreve të pyjeve është identifikimi i atyre parametrave që mundësojnë vlerësimin e rritjes së probabilitetit të zjarrit.

Te gjitha masat e ndërmarra pë mbrojtjen kundër zjarreve të pyjeve/kullota, sipas kohës që janë ndërmarrë dhe synimit ndahen në:

- **masat parandaluese;**
- **masat përgatitore;**
- **masat e lokalizimit dhe shuarjes.**

5.1 Masat parandaluese

Këto masa për mbrojtjen e pyjeve/kullotave nga zjarret merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Këto masa ju drejtohen totalisht njerëzve. Qëllimi kryesor i këtyre masave është të parandalojnë shfaqjen e zjarreve nëpërmjet evidentimit dhe parandalimit të shkaktarëve (shkaqeve) duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në **zvogëlimin e numurit të zjarreve.**

Bazuar në këtë, ato janë masat me efektive për mbrojtjen e pyjeve/kyllotave nga zjarret dhe sipas karakterit dhe aplikimit të tyre ato mund të ndahen në:

a) Masa ligjore;
b) Masa edukative;
c) Masa informative-propaganduese.

a) ***Masat ligjore***

Shteti shqiptar i adreson këto çështje në Kushtetutë dhe ligjet e tjera dhe me aktet nënligjore. Sipas ligjit, parandalimi i zjarreve në pyje, kullota, tokës me barëra, gjatë proceseve të të korrave në toka bujqësore apo aktivitete pastrimi rrallimi në frutikulturë etj., është përgjegjësi e pronarëve apo përdoruesve (NjVV, AdZM, fermerë privatë, sipërmarrës) apo atyre që menaxhojnë këto zona. Meqë pyjet janë thesar kombëtar, të gjithë qytetarët janë përgjegjës për parandalimin e zjarreve. Kështu, qeveria kalon akte normative, të cilat janë përcaktuar më tej në aktet nënligjore.

NjVV-ja, AdZM-ja, pronarët privatë dhe menaxherët e zbatojnë këtë në praktikë në bazë të vendimeve, urdhëresave etj. Kjo nënkupton që parandalimi bazë i zjarreve në pyje është kryesisht një përgjegjësi e atyre që menaxhojnë pyllin/kullotën.

Legjislacioni përcakton masat dhe aktivitetet, të cilat duhet të merren nga subjektet përgjegjëse, për parandalimin e zjarreve në pyje sikurse dhe dënimet për të vepruar në përputhje me ligjin.

Legjislacioni ekzistues për Shqipërinë:

1. Ligj Nr. 57/2020, datë 30.04.2020: "Për Pyjet";
2. Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 *"Për Fondin Kullosor"*, i ndryshuar;
3. Ligji nr. 10120, datë 23.4.2009 *"Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore"* i ndryshuar;
4. Ligji nr. 45, datë 18.7.2019 *"për Mbrojtjen Civile";*
4. Ligj Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
5. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF 2023-2030) Datë: 31 gusht 2022;
6. VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 "Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive";
7. VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile";
8. VKM nr. 747, datë 20.11.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile";
9. VKM nr. 531, datë 01.08.2003 "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile";
10. Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

b) ***Masat edukative***

Këto janë masat që përfshijnë edukimin e njerëzve. Ato mund të aplikohen me të gjitha grupmoshat, megjithatë janë me të suksesshme dhe të dobishme për të rinjtë. Këto masa kanë për qëllim të tregojnë rreziqet që sjell zjarri, por, gjithashtu, dobitë nga përdorimi korrekt i tij. Më efektive masat edukative janë te fëmijët parashkollorë dhe ata të shkollës fillore.

Këto masa mund të implementohen në disa mënyra: leksione të ndryshme për parandalimin e zjarrit në pyje e kullota; futja në shkolla e informimit të nevojshëm për zjarret dhe bërja e këtij informimi pjesë të kurikulave është një nga mënyrat më të suksesshme.

Media elektronike dhe e shkruar gjithashtu mund të përdoren (revistat, fletëpalosje, TV, radio, rrjete sociale etj.) përmes artikujve të përshtatshëm dhe shfaqjeve edukuese, ndërgjegjësuese.

Për këtë qëllim mund të publikohen revista të specializuara shkollore me përmbajtje të pasur. Libra me fotografi apo lojëra të ilustruara që përfshijnë përmbajtjen, e cila ka të bëjë me mbrojtjen kundër zjarreve në pyje dhe që janë efektive për fëmijët parashkollorë dhe shkollorë.

Qëllimi i tyre i fundit është që të familiarizojë fëmijët me këtë fushë dhe të nxisë dashurinë ndaj pyjeve/kullotave dhe natyrës dhe në veçanti të familiarizojë ata me pasojat dhe dëmet e zjarreve të pyjeve. E tërë kjo i ndihmon ata që të zhvillojnë një qëndrim të drejtë ndaj pyjeve si thesar kombëtar, dashurinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj pyjeve, se ata ruajnë të gjithë jetën e tyre.

Masat e përmendura më lart janë masa të përhershme, domethënë ato ndërmerren gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në periudhën e zjarreve të pyjeve.

c) ***Masat informative-propaganduese***

Këto masa kanë për qëllim të paralajmërojnë apo informojnë publikun (vizitorët e pyjeve, punëtorët etj.) rreth rreziqeve nga zjarret në pyje, duke orientuar si të sillen në pyje dhe t'i udhëzojnë ata rreth masave të menjëhershme që duhen ndërmarrë në rast të zjarrit.

Këto masa mund të komunikohen në disa mënyra:

1. Duke vendosur shenja në vendet e dukshme (në rrugë kryesore dhe anësore) që kanë të bëjnë me ndalimin e ndezjes së zjarrit në zonat e hapura, duke i shënuar vendet në pyje ku lejohen zjarret, shenjat që ndalojnë lëvizjen në pyje etj.
2. Nëpërmjet organizimit të takimeve dhe bisedave informative me grupe të ndryshme njerëzish, të cilët operojnë përkohësisht ose për një kohë të gjatë në pyje e kullota (barinj, fermerë, mbledhësit e frutave të pyjeve, biznese, turistë etj.)
3. Informacioni mund të komunikohet në forma të ndryshme, si: simbole, fletëpalosje, postera, debateve publike etj., me qëllim informimin rreth mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.

Për t'u siguruar që kanë ndikim të drejtë për njerezit që ne trajnojmë, duhet të mbajmë parasysh këto katër faktorë kryesorë:

- Synoni njerëzit e duhur;
- Përdorni/përcillni mesazhin e duhur;
- Gjeni kohën e duhur për mesazhin;
- Përdorimi mjetin/transmetuesin e duhur.

Për të arritur një sukses më të madh, masat informative-propaganduese mund të kombinohen me masat edukative.

Bisedat informative me blegtorët

5.2 Masat përgatitore

Duke pasur parasysh faktin që masat parandaluese asnjëherë nuk mund të parandalojnë plotësisht shfaqjen e zjarreve të pyjeve/kullotave, janë të nevojshme gjithashtu masat e tjera të ashtuquajtura masa parapërgatitore për shuarjen e zjarreve.

Masat parandaluese synojnë në parandalimin apo zvogëlimin e numrit të zjarreve të pyjeve/kullotave, ndërsa masat parapërgatitore për shuarjen e zjarreve na mundësojnë që të shuajmë zjarret në pyje/kullota në një mënyrë të organizuar.

Këto masa ndërmerren gjatë gjithë vitit dhe përfshijnë:

- zbulimin e zjarrit shpejt (në kohë) - vrojtimi dhe njoftimi/sinjalizimi;
- përcjelljen e informacioneve;
- organizimin e transportit për zjarrfikësit;
- furnizimin me mjetet dhe pajisjet e duhura;
- rekrutimin dhe trajnimin e zjarrfikësve;
- ndërtimin e brezave ndarës të lëndës djegëse dhe korridoreve për luftimin e zjarreve;
- hartën e lëndës djegëse dhe reduktimin e lëndës djegëse;
- përcaktimin e rrezikut të zjarrit;
- planin vjetor të masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave.

5.2.1 Zbulimi i zjarrit shpejt (në kohë) - vrojtimi dhe njoftimi/sinjalizimi

Zbulimi i zjarrit në kohë është shumë me rëndësi për lokalizimin dhe shuarjen e shpejtë të tij. Zbulimi i hershëm i zjarrit kërkon organizimin e një njësie vrojtimi për shkak të faktit se zonat malore janë shpesh të vështira për t'u monitoruar dhe kanë një shtrirje të madhe në sipërfaqe. Është i rëndësishëm funksionimi i kësaj njësie,

sidomos gjatë të ashtuquajturës *"periudhë kritike"* të vitit, kur numri i zjarreve në pyje/kullota është më i lartë.

Objektivat e zbulimit të hershëm/shpejt të zjarrit janë:

- ✓ zhvillimi i teknikave për zvogëlimin e ndezjes së padëshiruar të zjarreve;
- ✓ reduktimi i kostove për shuarjen e tyre;
- ✓ zvogëlimi i dëmeve në burimet natyrore dhe pasurive;
- ✓ reduktimi i rreziqeve të ekspozimit ndaj zjarrit.

Vrojtimi mund të kryhet në disa mënyra:

a) vrojtimi i terrenit nga kullat e vrojtimit;
b) patrullimi tokësor;
c) vrojtimi nga ajri;
d) vrojtimi automatik dhe elektronik.



Kulla e vrojtimit

a) Vrojimi i terrenit nga kullat e vrojtimit apo një pikë e lartë

Vrojtimi i terrenit nga një apo disa pika, bëhet prej personave (vrojtuesve) nga kullat e vrojtimit tashmë të ndërtuara apo nga ndërtimet ekzistuese. Vrojtuesit duhet të njohin terrenin dhe të pajisen me harta të zonës, të kenë në përdorim instrumente për përcaktimin e këndeve (busull), dylbi, radio apo instrumente sinjalizuese dhe vegla dore (lopatë, kazmë, fshesë metalike, enë me ujë etj.).

b) Patrullimi tokësor

Ndjekja e rrugëve të caktuara përmes pyllit, në këmbë apo me mjete motorike, quhet patrullim. Patrullimi mund të organizohet me objektiv të veçantë ose të jetë pjesë e disa aktiviteteve të tjera të bëra nga i njëjti person (p.sh.: pylltarë, punëtorë të pyjeve, inxhinierë të pyjeve etj., krahas detyrave të tjera të menaxhimit, të kryejnë patrullimin.)

Personi apo personat që patrullojnë duhet të kenë mjete komunikuese në mënyrë që të raportojnë në kohë rënien e zjarrit.

Për të qenë të sigurt për mbulimin e gjithë zonës pyjore, hartohet dhe ndiqet një plan patrullimi.

Objektivat e këtij plani duhet të jenë:

- Reduktimi i numrit të zjarreve të padëshiruar në pyje;
- Parandalimi i dëmeve;
- Minimizimi i rrezikut të jetës, pasurisë natyrore dhe kulturore.

Plani duhet të jetë **i përgatitur mirë**, duke pasur parasysh:

- Historikun e zjarreve në zonë dhe potencialin e rënies së tij;
- Prioritizon vendndodhjen e zjarrit në pyje;
- Identifikon periudhat më efektive të kohës duke ruajtur **fleksibilitetin.**

(Shih Shtojcën 1)

Patrullimi në këmbë për zbulimin e hershëm të zjarreve

c) Vrojtimi nga ajri

Vendet më të zhvilluara apo vendet që posedojnë sipërfaqe të mëdha me pyje, përdorin mjetet ajrore (drone, aeroplanët, helikopterët etj.) për zbulim të zjarrit në kohë. Mund të formohet një skuadër speciale ajrore ose të përdoren aeroplanë sportivë. Aeroplanët që janë pjesë e njësive speciale mund të bartin ujë dhe menjëherë fillojnë shuarjen e zjarrit.

d) Vrojtimi automatik dhe elektronik

Ky lloj vrojtimi është mënyra më bashkëkohore për të zbuluar zjarret dhe kryesisht përdoret për sipërfaqet e pambërritshme dhe për sipërfaqet e mëdha me pyje. Këto stacione janë të pajisura me pajisje speciale (me kamera dhe pajisje të tjera elektronike), të cilat në mënyrë automatike dhe të pavarur (pa prezencën e njerëzve) vrojtojnë terrenin dhe në rast të zjarrit, dërgojnë informata në qendrën relevante.

Në mes të shumë përparësive, ekzistojnë dhe të meta, siç është dhënia e alarmit të rremë, shkaktuar nga tufa zogjsh apo insektesh, të cilat regjistrohen nga stacioni, si tym zjarri etj.

5.2.2 Përcjellja e informatave

Zbulimi i zjarrit ne kohë pa përcjelljen e shpejtë të informatave, nuk do të kishte efektin e dëshiruar. Mënyra më e mirë për përcjelljen e informatave është përdorimi i mjeteve komunikuese. Kërkohet një rrjet i transmetueseve me kualitet të lartë dhe ritransmetues, të cilët të mundësojnë një kualitet të lartë dhe me mbulim në të gjithë territorin, si dhe pajisje të përshtatshme për vrojtuesit (radio, telefon celular).

5.2.3 Organizmi i transportit për zjarrfikësit

Organizimi i transportit për zjarrfikësit ka një rëndësi të madhe edhe për vetë zjarrin. Nëse kemi zbuluar me kohë zjarrin dhe kemi përcjellë shpejt informacionin, transporti i organizuar i zjarrfikësve, u mundëson atyre që të arrijnë në vendin ku ka ndodhur zjarri, duke lokalizuar dhe shuar atë.

Zjarrfikësit dhe pajisjet e tyre mund të transportohen duke përdorur kafshë, fuoristrada, automjete speciale, helikopterë etj. Kjo varet nga karakteristikat e terrenit ku ka ndodhur zjarri, si dhe nga mjetet financiare në dispozicion apo infrastruktuara logjistike. Rrugët dhe koha e nevojshme për transport duhet të planifikohen paraprakisht, pasi zvogëlojnë shumë kohën e ndërhyrjes kur ndodh një zjarr.

5.2.4 Furnizimi me vegla dhe pajisje të duhura

Pavarësisht nga numri i mjaftueshëm i zjarrfikësve të trajnuar, furnizimi me vegla dhe pajisje të përshtatshme për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit ka një rëndësi të madhe.

Kjo na bën të kuptojmë se furnizimi me vegla dhe pajisje për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve nuk duhet të jetë gjithnjë i njëjtë pasi domosdoshmëria e pasjes së tyre varet nga disa faktorë si: lloji i lëndës djegëse, konfiguracioni i terrenit, trajnimi i zjarrfikësve etj. Për shembull, për një zonë ku dominon bari, kërkohen fshesat e hekurit, lopatat metalike, kazmat, enët me ujë etj., ndërsa për zonën me pyje të larta, pavarësisht nga veglat e listuara më lart, kërkohen motorsharrat, sëpatat, makineritë më të rënda (buldozeri, traktori etj).

Veglat e dorës gjithmonë duhet të jenë në gjendje pune (të mprehura, me doreza të forta etj.) dhe të mbahen në vende të veçanta për atë qëllim.

Makineritë e rënda që përdoren në punët e përditshme, mund të mobilizohen gjatë zjarreve në pyje duke garantuar funksionimin dhe gatishmërinë teknike të tyre.

Kushtet që duhet të plotësohen nga veglat dhe pajisjet janë që:

- të kenë efikasitet dhe produktivitet më të lartë;
- të jenë universale;
- të mund të transportohen lehtë;
- të jenë të qëndrueshme, p.sh.: të jenë të bërë nga një material me cilësi të lartë;
- të jenë të thjeshta për t'u përdorur.

Sipas llojit të punës së kryer me vegla dhe pajisje, ato mund të ndahen në:

Veglat për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve

- pajisje dhe vegla për prerjen dhe rrëzimin e trungjeve;
- pajisje dhe vegla për mbledhje, shtyrje dhe goditje;
- pajisje dhe vegla për gërmim dhe ndërtimin e zjarr-ndarësve;
- pajisje për ujë;
- pajisje për fillimin e zjarrit të kundërt;
- pajisje për ndriçim gjatë shuarjes së zjarrit natën;
- pajisje dhe vegla për minim.

5.2.5 Rekrutimi dhe trajnimi i zjarrfikësve

Lokalizimi dhe shuarja e zjarreve të pyjeve është aktivitet shumë i vështirë fizik dhe psikologjik. Në shumicën e rasteve, kushtet e terrenit janë të rënda (temperaturë e lartë, zonat e pakalueshme dhe të pjerrëta, përqendrim i lartë tymi etj.).

Zjarrfikësit e zgjedhur duhet të jenë fizikisht dhe mentalisht të shëndetshëm, si dhe të trajnuar mirë. Ata duhet të njohin taktikat e lokalizimit dhe shuarjes, si dhe veglat e pajisjet për ato qëllime.

5.2.6 Ndërtimi i brezave ndarës të lëndës djegëse dhe korridoreve për luftimin e zjarreve

Me qëllim lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve të mëdha pyjore, zjarrfikësit duhet të kenë pozicion të sigurtë mbrojtës nga ku ata do të shuajnë zjarrin. Për shkak të nxehtësisë së lartë dhe shpejtësisë së përhapjes, këto pozicione krijohen në një distancë të caktuar, në zonën para pjesës së përparme të zjarrit.

Lënda djegëse duhet të hiqet në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Për të fituar më tepër kohë, heqja e lëndës djegëse nga ndërprerësja e zjarrit bëhet para rënies së zjarrit.

Brezat ndarës të lëndës djegëse (korridoret e mbrojtjes nga zjarri) janë vende përgjithësisht të pastruara nga lënda djegëse. **Ato krijohen gjatë aktiviteteve të rregullta pyjore dhe janë zona të pastra, pa asnjë lëndë djegëse.** Nganjëherë, bimët që nuk digjen lehtë, mund të rriten në brezat ndarës të lëndës djegëse.

Edhe kombinimi i halorëve me fletorë mund të krijojë një brez ndarës mjaft të efektshëm. Gjerësia e brezave ndarës ndryshon, varësisht nga lartësia e trungjeve, pjerrësia e terrenit, lartësia e flakës (lartësia e pritshme e flakës) etj., por mesatarisht ato variojnë nga 6-50 metra të gjera.

Brezat ndarës të lëndës djegëse gjithashtu mund të shërbejnë si korridore për ndërhyrje të shpejtë për luftim të zjarrit.

Brezat ndarës të lëndës djegëse mund të krijohen duke përdorur një nga teknikat / mjetet e mëposhtme:

- Herbicidet - kërkon planifikim më parë;
- Eskavatorë dhe buldozerë;
- Bimësi të prerë - heqje totale;

- Shkumë - kohëzgjatja e shkurtër;
- Djegie vegjetacioni (e kontrolluar);
- Mbjellje të llojeve vështirë të djegshëm dhe të kombinuar (halorë - fletorë):

5.2.7 Harta e lëndës djegëse dhe reduktimi i lëndës djegëse



Brez ndarës i lëndës djegëse i pastruar

Një rrugë auto si brez ndarës i lëndës djegëse

Siç u përmend edhe më sipër, pavarësisht nga faktorët e tjerë, mundësia e një brezi ndarës zjarri dhe sjellja e zjarrit varen nga lloji i lëndës djegëse dhe karakteristikat e saj.

Njohja e karakteristikave dhe shpërndarjes së lëndës djegëse përcakton masat e nevojshme, të tilla si zgjedhja e mjeteve të përshtatshme dhe pajisjeve të shuarjes së zjarrit në pyll/kullotë, zgjedhja e taktikave të shtypjes në rrethana të caktuara (moti, konfigurimi i terrenit) etj.

Për shkak të kësaj rëndësie të lëndës djegëse, dhe me qëllim që të fitohet një pasqyrë e qartë e gjendjes në terren, lënda djegëse është ***hartografuar*** dhe klasifikuar në klasat e lëndës djegëse. Këto të dhëna shërbejnë për të organizuar më mirë mbrojtjen kundër zjarreve si pjesë e masave të tjera parapërgatitore.

Masat e reduktimit të lëndës djegëse merren në vendet ku është vlerësuar se sasia e lëndës djegëse është e lartë dhe e karakteristikave të tilla që ajo posedon një kërcënim të shfaqjes së zjarrit. Kjo mund të kryhet në disa mënyra që varen nga lloji i bimësisë, pajisjeve dhe e legjislacionit në dispozicion etj.:

- lëvizje e barit;

- trajtimit me herbicide;
- djegie të parashikuar/të kontrolluar etj.

Djegia e parashikuar/kontrolluar është zbatimi i planifikuar i zjarrit në kushtet e përcaktuara mjedisore dhe brenda kufijve të përcaktuar, për të arritur objektivat e menaxhimit të burimeve.

Përdorimi i zjarrit (djegia e parshikuar/kontrolluar) është një mënyrë shumë efektive për reduktimin e lëndës djegëse, por përdorimi i saj kërkon njohuri dhe eksperiencë të madhe. Kjo mënyrë e uljes së lëndës djegëse më shpesh përdoret për të eliminuar mbetjet pas prerjeve, veçanërisht prerjeve sanitare, dhe është përdorur në përgjithësi për zvogëlimin e lëndës djegëse gjatë aktiviteteve të rregullta pyjore.

Trajnimi i duhur i personave, kombinuar me legjislacionin, do të kontribuojë ndjeshëm në uljen e numrit të zjarreve.

Gama e objektivave përfshin:

- Krijimin e korridoreve kundra zjarrit;
- Ulje e ngarkesave të lëndëve djegëse;
- Përmirësimi i habitateve për kafshë të egra;
- Hapja e tokave të reja bujqësore;
- Përmirësimi i kullotës;
- Heqja e vegjetacionit sipërfaqësor dhe shtresës së mbeturinave të sipërme për të ndihmuar rigjenerimin natyral të drurëve apo shkurreve;
- Heqja e degëve, mbetjeve të rezultuara nga rrëzimi i drurëve dhe hapja e rrugëve për rimbjellje;
- Ofrim i një plehërimi natyror të tokës;
- Ruajtja e peizazheve kulturore të hapura.

5.2.8 Përcaktimi i rrezikut të zjarrit

Qëllimi kryesor i kësaj mase është për të përcaktuar rrezikun e një rënieje zjarri në hapësirë dhe kohë sa më saktësisht të jetë e mundur.

Kjo do të thotë t'i përgjigjesh pyetjes:

A ka kushte lënda djegëse për të filluar djegien dhe ku?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje ka disa metoda me saktësi të ndryshme, bazuar kryesisht në kushtet e motit dhe karakteristikat e lëndës djegëse. Ky vlerësim mund të jetë afatgjatë dhe afatshkurtër.

Metoda afatgjatë është e bazuar në të dhënat e fundit statistikore, karakteristikat klimatike të rajonit, llojin e vegjetacionit, faktorin njeri etj. Kjo metodë ka saktësi më të ulët dhe i referohet një periudhe më të gjatë kohe.

Metoda afatshkurtër e vlerësimit të rrezikut nga zjarri, pra parashikimi i

përditshëm, është më e rëndësishme. Ajo bazohet në kushtet e motit gjatë ditës dhe në gjendjen e lëndës djegëse (kryesisht në përqindjen e lagështisë në të). Në fakt, kjo metodë përllogarit probabilitetin e rënies së zjarrit brenda një periudhe 24-orëshe. Ajo u mundëson institucioneve përkatëse dhe pjesës tjetër të qytetarëve për të marrë masa me qëllim ndalimin e shpërthimit të zjarrit (masa të përcaktuara për çdo shkallë rreziku) ose për të rritur shkallën e gatishmërisë së forcave të luftimit të zjarrit të bazuar në kohë.

Intensiteti i zjarrit mund të shprehet në kilovat (kw) për metër linear. Intensiteti i zjarreve test është llogaritur duke përdorur një formulë australiane dhe mund të lidhet me lartësinë e flakës. Intensiteti i zjarrit do të ndryshojë me ndryshimin e kushteve. Për shembull, një rritje në lartësi të shqopës (rrit sasinë e lëndës djegëse) po të shoqërohej me një rritje në shpejtësi të erës, do të rrisë ndjeshëm intensitetin e zjarrit. Një dyfishim i lëndës djegëse në dispozicion mund të katërfishojë intensitetin e zjarrit.

Intensitetet e linjës së zjarrit, lidhur me fazat e rritjes së shqopës, bazuar në lartësinë e flakës në kushtet australiane, janë paraqitur në tabelë (ANEKS 5). Lartësia e flakës matet pingul me tokën, ndërsa gjatësia e flakës është distanca përgjatë gjatësisë së flakës, që zakonisht është më e madhe se lartësia. Sistemet e shuarjes për intensitetet e dhëna janë të lidhura gjithashtu me klasifikimin Australian të Rrezikut të Zjarrit. Për të parashikuar rrezikun e zjarrit në një vend të caktuar, shkalla e mundshme e përhapjes (ROS), intensiteti i vijës së zjarrit, duhet të jetë e njohur më parë qasja dhe shtrirja e fronteve të zjarrit. Për llogaritjen e intensitetit të vijës së zjarrit, të cilat mund të lidhen drejtpërdrejt me lartësinë e bimësisë së shqopës, duhet të dihen (njihen) sasitë e lëndës djegëse.

Puna mund të vazhdojë duke krijuar një metodë në përputhje të parashikimit të sasive të lëndës djegëse për të gjitha llojet e bimësisë. Me këtë informacion do të jetë e mundur që të përcaktohet se cili sistem shuarjeje është më i përshtatshëm për t'u zbatuar, duke përdorur të dhënat e mbledhura më parë për të llogaritur kohën e nevojshme për shuarjen e zjarrit.

Nëse do të dispononim këto të dhëna, atëherë për zjarret e mëdha do të ishte e mundur të vlerësohej se sa larg do të përhapej zjarri dhe nëse do të ishte e mundur që me burimet aktuale do të arrihej në kohën e duhur te zjarri. Megjithatë, edhe pse kjo është një metode e mirë dhe e strukturuar, ajo mund të prishet nga mungesa e të dhënave/informacionit në dispozicion dhe ndryshimet e kushteve në pjesën ballore të zjarrit. Ky informacion mund të shërbejë si bazë për të justifikuar thirrjen e helikopterëve, e cila është parë shpesh si një alternativë e shtrenjtë dhe me afat të shkurtër. Metoda mund të përdoret për të planifikuar krijimin e ndërprerësve të zjarrit dhe llogaritur terrenin e humbur.

5.2.9 Plani vjetor i masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave

Strukturave që menaxhojnë pyjet/kullotat dhe tokat pyjore, u kërkohet nga ligji të përgatisin planet operacionale vjetore për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota.

Këto plane duhet të përbëhen nga tri pjesë.

Në pjesën e parë, jepet një përmbledhje dhe analizë e gjendjes së zjarreve në pyje në të kaluarën në rajon, duke marrë parasysh të gjitha aspektet (numrin e zjarreve, shkaqet, zonën e djegur, pajisjet për shuarjen e zjarrit dhe mjetet e përdorura, taktikat, numrin e personave të përfshirë, kushtet e motit, orën kur filloi zjarri, vendndodhjen etj.).

Pas nje analize të hollësishme në pjesën e parë, duke u bazuar në të dhënat, në pjesën e dytë planifikohen masat parandaluese dhe të shuarjes për vitin e ardhshëm.

Pjesa e tretë përbëhet nga një listë e detajuar e personave që do të zbatojnë këto masa, me datat e sakta dhe duke përfshirë afatet. Për qëllime të vrojtimeve të planifikuara gjatë periudhës kritike të vitit për rënien e zjarrit, duhet përgatitur një listë e hollësishme e personave, pajisjeve dhe automjeteve të ndara në ekipe me orare vrojtimi.

Procedurat që duhen ndjekur në situata të caktuara dhe harta të ndryshme (harta e lëndëve djegëse, rrugët, rezervuaret e ujit etj.), duhet të përfshihen si shtojca të këtij plani.

Ajo që përshkruam më sipër tregon qartë rëndësinë e masave përgatitore, të cilat janë të një rëndësie të madhe. Efikasiteti i masave luftuese varet nga to..

5.3 Masat direkte të lokalizimit dhe shuarjes

Pavarësisht nga masat parandaluese, gjithmonë do të ndodhin zjarre në zonat e hapura. Për këtë arsye, hartohen masat që ndërmerren gjatë një zjarri, dhe qëllimi i tyre është të lokalizojnë dhe shuajnë zjarrin .

Për të lokalizuar apo shuar një zjarr, është e domosdoshme të eliminohet një nga elementet e të ashtuquajturit trekëndësh i Osbornit (zjarrit), domethënë materiali që është duke u djegur, burimi i nxehtësisë ose oksigjeni. Nisur nga materiali që përdorim për e shuarjen e zjarrit, metodat emërtohen:

a) Shuarja e zjarrit me dhe (metoda e dheut);
b) Shuarja e zjarrit me ujë (metoda e ujit);
c) Shuarja e zjarrit me zjarr (metoda e zjarrit);
d) Shuarja e zjarrit me substanca kimike (metoda kimike);
e) Shuarja e zjarrit me eksploziv (metoda eksplozive);
f) Shuarja e zjarrit me aeroplan (hedhja e ujit nga ajri).

Si do t***ë*** aplikohen k***ë***to metoda n***ë*** kushtet e terrenit p***ë***r fikjen e zjarreve?



Heqja e disa elementeve të trekëndëshit të zjarrit

a) ***Shuarja e zjarrit me dhe (metoda e dheut)***

Metoda e shuarjes së zjarrit nëpërmjet hedhjes së dheut është metoda më e vjetër e shuarjes së zjarrit. Ne këtë metodë përdoret dheu ose rëra.

Në varësi të taktikave të përdorura për shuarjen, dheu hidhet direkt në pjesën e përparme të flakës.

Dheu vepron si izolator, duke shmangur kontaktin e oksigjenit me lëndën djegëse. Duke mbuluar materialin që digjet me dhe, ajri nuk mund të bjerë në kontakt me të dhe djegia ndalet). Gjithashtu, dheu vepron si izolator i nxehtësisë. Kjo do të thotë se energjia e nxehtësisë që është e nevojshme për djegien e një druri, nuk mund të hyjë në të për shkak të shtresës së dheut mbi lëndën djegëse. Prandaj, në këto kushte,

lënda djegëse nuk mund të ndizet, ose së paku nuk mund të ndizet lehtë.

b) ***Shuarja e zjarrit me ujë (metoda e ujit)***

Siç është konstatuar tashmë, metoda me ujë është forma më e njohur për shuarjen e zjarrit. **Uji ka ndikim të shumëfishtë në procesin e djegies.**

Së pari, lagështia në materialin që digjet, ose në materialin në zonën para pjesës së përparme të zjarrit, humb energjinë e nxehjes përmes procesit të avullimit, duke ulur kështu temperaturën poshtë pikës së ndezjes. Si rezultat, zjarri shuhet.

Së dyti, për shkak të avullimit të ujit, prezenca e avullit në ajër rritet. Avulli dhe tymi i çliruar nga zjarri zvogëlojnë përqindjen e oksigjenit ne ajër, gjë që çon në zvogëlimin e intensitetit të zjarrit, ose nganjëherë e shuajnë atë (në varësi të dendësisë së avullit dhe tymit).

Ekziston një numër taktikash dhe pajisjesh të ndryshme për këtë metodë (nga ato manuale deri te pajisjet mekanike). Është një metodë shumë e suksesshme, por problemi është që uji nuk gjendet gjithmonë afër zjarrit. Prandaj, duhet gjithmonë të transportohet ne vendndodhjen e zjarrit. Transporti është një problem serioz për shkak të sipërfaqeve malore të paarritshme, të cilat e bëjnë zbatimin e kësaj metode më të vështirë dhe zvogëlojnë efektivitetin e saj.

c) Shuarja e zjarrit me zjarr (metoda e zjarrit)

Në këtë metodë, përdoret zjarri për të shuar zjarrin. Kjo metodë e pastron terrenin nga lënda djegëse që e shuan zjarrin. Në fakt, ajo varet nga taktikat e përdorura për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri kryesor. Zjarri i "kontrolluar" (i cili mund të lëvizë në drejtim të njëjtë apo të kundërt me zjarrin kryesor) djeg lëndën djegëse në zonë përpara se të ndizet nga pjesa e përparme e zjarrit.

Kur zjarri arrin zonën ku ka qenë zjarri "i kontrolluar", aty nuk ka mbetur asgjë për t'u djegur, dhe kështu zjarri shuhet.

Vlen të theksohet se kjo metodë është shumë efektive, por e rrezikshme.

Këtë metodë e përdorin vetëm ekspertët dhe personat me përvojë (zjarrfikësit), duke e ruajtur plotësisht zjarrin e "kontrolluar", domethënë duke e ruajtur që të mos dalë jashtë kontrollit dhe të ketë pasoja të padëshiruara.

Ndezja dhe kontrolli i këtij zjarri duhen bërë kundër erës dhe/ose pjerrësisë së shpatit. Mos përparoni me ndezjen e zjarrit më shpejt nga sa mund të ndjekin forcat e kontrollit. Lënda djegëse jashtë brezit të kontrollit mund të shuhet me qëllim ndalimin e daljes së zjarrit nga brezi i kontrollit.

Ndezja e lëndës djegëse mund të bëhet në një apo më shumë breza, duke i lënë ato të digjen në të njëjtën kohë. Kjo lejon një djegie më të shpejtë. Gjerësia dhe vendosja

e brezave, përkundrejt pozicionimit të shpatit apo drejtimit të erës, rregullojnë intensitetin e djegies.

Metoda e ndezjes rrethore mund të përdoret përreth ndërtesave apo në zona të caktuara.

Në mënyrë që të kemi kontroll të plotë të këtij zjarri, duhet të merren disa masa paraprake, si: ekipet e zjarrfikësve të pajisen me pajisjet e duhura, përdorimi i ujit në dispozicion nga depozita me ujë të jetë siguruar etj.

Sigurohuni që të gjitha zonat e nxehta dhe rrugët e mundshme për devijimin e zjarrit të jenë nën kontroll nga forcat e kontrollit të zjarrit.

d) Shuarja e zjarrit me substanca kimike (metoda kimike)

Në këtë metodë të shuarjes përdoren substanca të ndryshme kimike. Në parim, kjo është një metodë me ujë, për faktin se të gjitha substancat kimike, gati pa përjashtim, treten në ujë dhe përmirësojnë karakteristikat e tij. Deri në 70% e ujit të përdorur për shuarjen e zjarreve të pyjeve humbet.

Kjo është arsyeja pse shtohen substanca të ndryshme kimike për të përmirësuar efektin e shuarjes.

Midis shumë avantazheve, e meta më e madhe e metodës kimike është çmimi i substancave kimike (disa prej të cilave janë shumë të shtrenjta), disa e dëmtojnë mjedisin, domethënë ndotin ambientin ose janë toksike. Së fundi, i është kushtuar shumë vëmendje aspektit mjedisor të substancave kimike, dhe pothuajse të gjitha substancat që përdoren janë miqësore me mjedisin.

e) Shuarja e zjarrit me eksploziv (metoda eksplozive)

Sipas rrethanave të caktuara, mund të përdoret eksplozivi për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve të pyjeve/kullotave. Kjo varet nga nevoja, eksplozivi mund të përdoret si shtesë në metodat e tjera (heqja e cungjeve, gërmimi i kanaleve, ndërtimi i brezave ndalues/mbrojtës etj.), apo direkt për shuarjen e zjarrit.

Kur përdoret drejtpërdrejt për shuarje, eksplozivi funksionon në dy mënyra. Mënyra e parë, kur eksplozivi i vendosur në tokë shpërthen, krijohet një "re pluhuri" e madhe, e cila zvogëlon përqindjen e oksigjenit në ajër, duke zvogëluar intensitetin e zjarrit ose e shuan tërësisht atë. Ky shpërthim, gjithashtu, heq lëndën djegëse, duke bërë që të mos mbetet asgjë për t'u djegur.

Mënyra e dytë përfshin një shpërthim të shkaktuar në momentin kur kreu i zjarrit është mbi eksploziv. Përveç sa u tha më lart, në këtë rast, ajri shpërndahet me shpejtësi (një shpërthim) si rezultat zjarri mbetet pa ajër, pra pa oksigjen, kështu që shuhet.

Kjo është një metodë shumë efektive që mund të zëvendësojë shumë zjarrfikës, por në të njëjtën kohë është jashtëzakonisht e rrezikshme, po qe se nuk aplikohet

korrekt dhe në kohë. **Për shkak të gjitha këtyre, përdorimi i eksplozivit duhet bëhet me shumë kujdes nga ekspertët dhe personat e trajnuar për këtë qëllim**.

f) Shuarja e zjarrit me aeroplan (hedhja e ujit nga ajri)

Në parim, kjo është një metodë shuarjeje me ujë (nganjëherë edhe kimike), por për shkak që është shumë specifike, klasifikohet si metodë e ndarë. Përveç aeroplanëve, helikopterët gjithashtu përdoren për këtë metodë në ditët e sotme. Ekzistojnë lloje të specializuara aeroplaanësh për këtë qëllim, por përdoren edhe aeroplanë të tjerë.

Kjo është një metodë shumë e përshtatshme për shkak të shpejtësisë së aeroplanëve dhe helikopterëve, kapacitetit të tyre (mund të mbulojnë territore të mëdha), hyrja e tyre në terrene të paarritshme (posaçërisht në male), sasia e ujit që ata mund të transportojnë etj.

Lokalizimi apo shuarja e zjarrit mund të bëhet individualisht, apo në kombinim me zjarrfikësit në terren.

6 TAKTIKAT PËR LOKALIZIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE TË PYJEVE

Metodat për lokalizimin e zjarreve të pyjeve janë përshkruar në kapitujt e mëparshëm, por nëse do të aplikohen veçmas apo në një kombinim të caktuar, ato varen nga një numër faktorësh, kryesisht nga tipi i pyllit. Bazuar në këtë, taktikat për shuarjen e zjarreve të pyjeve në përgjithësi ndahen në:

- Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e një **zjarri nëntokësor;**
- Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e një **zjarri sipërfaqësor;**
- Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e një **zjarri të kombinuar.**

6.1 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit nëntokësor

Kjo taktikë përdoret për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve nëntokësore. Zjarret nëntokësore janë zjarre specifike të pyjeve/kullotave, të cilat shfaqen nën sipërfaqen e lëndës djegese (zakonisht ato janë shtresa të thella të torfeve, gjetheve etj.). Tipike për ta është djegia që ndodh nën sipërfaqe pa flakë dhe sasi të vogla tymi. Këto zjarre janë shumë të vështira për t'u zbuluar, lokalizuar dhe shuar.

Taktika e përdorur për lokalizim dhe shuarje është ajo e gërmimit të kanaleve të izolimit përballë linjës së zjarrit.

Në fakt, zbulimi i cepit të zjarrit është gjëja më e vështirë. Me qëllim për të zbuluar cepin e zjarrit, gërmohen kanale të thella deri në tokë të fortë (celinë). Pasi cepi i zjarrit është përcaktuar, paralel me të në një distancë të caktuar para tij, gërmohet një kanal izolimi.

Ky kanal është 50 cm i gjerë dhe i thellë deri në tokë të fortë (celinë), apo aq thellë sa të jetë e mundur. Kjo është një procedurë e vështirë për shkak të llojit të lëndës djegëse - torfe (lëndë organike e pakalbur), për shkak të terrenit, rrënjëve të drurëve, etj.

Ndërsa hapni kanalin e izolimit, materiali që është duke u gërmuar hidhet në sipërfaqen nga ana e zjarrit. Në rast se kanali kalon në rrënjët e një trungu të kapur tashmë nga zjarri, gjithë trungu konsiderohet i përfshirë nga zjarri dhe rrethohet nga kanali. Pasi i tërë zjarri është i rrethuar me një kanal izolimi, nëse ka ujë në afërsi, është mirë që ai të mbushet me ujë.

Ky lloj zjarri është shumë specifik dhe vështirë për t'u shuar, prandaj njerëzit duhet ta vrojtojnë atë për një kohë të caktuar, në mënyrë që të jenë të sigurt që ky është shuar komplet dhe nuk përhapet.

6.2 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit sipërfaqësor

Gjatë zjarreve tokësore/sipërfaqësore, lënda djegëse digjet në sipërfaqe me flakë që zakonisht arrijnë deri në 1.5 m lartësi. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve tokësore/sipërfaqësore, kjo varet nga një numër faktorësh, por në përgjithësi ato ndahen në dy grupe bazë: direkte dhe indirekte.

Metoda direkte e lokalizimit dhe shuarjes së zjarrit përdoret kur zjarri lejon zjarrfikësit t'i afrohen pjesës së përparme të tij (shpejtësia është e përhapjes është e vogël, maksimumi 500 m/h, lartësia e flakës është përafërsisht 0.5m etj.). Në rrethana të tilla, zjarrfikësit mund të spërkasin ujin direkt në materialin që është duke u djegur, në pjesën e përparme të zjarrit, hedhin dhe, godasin flakën me të ashtuquajturën "fshesë hekuri" apo të kombinojnë njëherësh disa nga metodat e përmendura më lart.

Një metodë tjetër është ajo e "dy hapave", e cila është në fakt një kombinim i metodës direkte dhe indirekte të lokalizimit dhe shuarjes së zjarrit sipërfaqësor. Në një distancë të caktuar nga zjarri (sa më afër që është e mundur) në formë të vijës ndërprerëse, lënda djegëse pastrohet në gjerësi prej 60 cm dhe dheu gërmohet dhe hidhet direkt në zjarr. Në këtë mënyrë, lënda djegëse hiqet nga terreni dhe krijohet një sipërfaqe e pastër përafërsisht 60 cm e gjerë. Në të njëjtën kohë, hedhja e dheut direkt në flakë i zë frymën dhe ndihmon në shuarjen e zjarrit.

Aplikimi i metodave direkte dhe indirekte

Metoda me dy hapa

Kur zjarri lëviz me shpejtësi të madhe (mbi 500 m/h, nganjëherë madje 2.5 km/h), lartësia e flakës është deri rreth 1.5 m, disa nga mënyrat e lartpërmendura nuk mund të përdoren. Përdoren të ashtuquajturat metoda indirekte për lokalizim dhe shuarje.

Metoda paralele është një ndër metodat indirekte. Kur përdoret kjo mënyrë e shuarjes, metoda e zjarrit, p.sh.: përdoret zjarri. Varësisht nga shpejtësia dhe fuqia e zjarrit, konfiguracioni i terrenit, numri dhe aftësitë e zjarrfikësve, në një distancë të caktuar nga zjarri, ndizet një zjarr tjetër i kontrolluar. Zjarri i kontrolluar është paralel me zjarrin kryesor p.sh., ata lëvizin në të njëjtin drejtim.

Pasi zjarri i kontrolluar djeg një zonë prej rreth 4-8m të gjerë para pjesës së përparme të zjarrit, ai shuhet nga zjarrfikësit, të cilët e kontrollojnë atë duke aplikuar disa nga metodat direkte. Kur zjarri arrin sipërfaqen e djegur, ai do të shuhet për shkak të mungesës së lëndës djegëse.

Ekziston një mënyrë tjetër në të cilën përdoret zjarri, kur shuhet zjarri tokësor/sipërfaqësor, i ashtuquajturi **zjarr i kundërt.** Në këtë rast, kjo varet nga shpejtësia e përhapjes së zjarrit dhe konfiguracioni i terrenit, ndizet zjarri i kontrolluar në zonën para pjesës së përparme të zjarrit. Diferenca krahasuar me rastin e mëparshëm është që zjarri i kontrolluar lëviz në drejtim të kundërt, domethënë lëviz drejt zjarrit kryesor. Kur dy zjarret takohen, së pari ka djegie intensive dhe pastaj zjarri shuhet, për shkak se nuk mbetet më lëndë djegëse.

Në të dyja rastet, kur përdoret metoda e zjarrit, ekziston rreziku i daljes nga kontrolli të zjarrit të kontrolluar. Për shkak të gjithë kësaj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur i përdorim këto dy metoda të shuarjes së zjarreve, dhe ato duhet të përdoren vetëm nën urdhër të ekspertëve dhe zjarrfikësve me përvojë.

Një tjetër mënyrë indirekte e lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve sipërfaqësore është bërja e **ndërprerëses së zjarrit**. Kjo varet nga shpejtësia e shpërndarjes së zjarrit, konfigurimi i terrenit, numrit të zjarrfikësve dhe pajimeve të tyre, në një distancë të caktuar nga pjesa e përparme e zjarrit bëhet një ndërprerës zjarri.

Kjo do të thotë që gjithë lënda djegëse largohet nga terreni duke krijuar një linjë të gjerë 2-4 m.

Largohen gjethet dhe degët e rëna, fidanët njëvjeçarë, shkurret dhe drurët e ulët. Trungjet e vjetra me lëvore të trashë (si dushku, pisha etj.), nuk hiqen, por ju priten degët e tyre të poshtme deri 2-2.5 m nga toka. Për bërjen e ndërprerësve të zjarrit duhet të përdoren sa të mundet edhe ndërprerësit ekzistues apo vendet me gurë, burimet, vendet pa vegjetacion, rrugët etj. Këta ndërprerës përdoren si pjesë e ndërprerëses së zjarrit, e cila i bën gjërat më të thjeshta dhe rrit eficiencën.

Pasi është pastruar ndërprerësi i zjarrit, në mes gërmohet një kanal rreth 0.5 m i gjerë deri në thellësinë e shkëmbit amnor. Dheu që gërmohet, hidhet në anën nga është zjarri. Kur zjarri arrin ndërprerësen e zjarrit, ai ndesh një sipërfaqe të pastruar nga lënda djegëse dhe si rrezultat shuhet. Zjarrfikësit presin në anën tjetër të ndërprerësit të zjarrit gati për të vepruar në rast se zjarri mund të kalojë mbi ndërprerësin e zjarrit. Në një rast të tillë, zjarri shuhet me disa nga metodat direkte. Kjo metodë është shumë efektive, por kërkon një numër të mjaftueshëm zjarrfikësish, disa herë makineri, dhe mbi të gjitha organizim të mirë.

6.3 Taktika për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit të kombinuar

Lokalizimi dhe shuarja e zjarrit të përgjithshëm apo të kombinuar është një ndër detyrat më të vështira në fushën e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret. Gjatë këtyre zjarreve, digjet e gjithë lënda djegëse në tokë edhe trungjet, dhe pika qendrore që digjet gjendet në kurorat e drurëve, e cila është arsyeja pse këto zjarre janë quajtur edhe zjarre të larta. Shpejtësia e përhapjes së zjarrit dhe sasia e energjisë së çliruar, domethënë temperatura, e bën më të vështirë lokalizimin dhe shuarjen e tyre.

Shpejtësia e përhapjes ndryshon nga 2-6 km/h, por gjithashtu ka zjarre që përhapen mbi 20 km/h (për shembull, zjarri uragan, zjarret e egra etj.). Temperatura e çliruar gjatë zjarreve të kombinuara është mbi 1000 ^{0}C. E gjithë kjo, e kombinuar me terrenet malore të paarritshme, e vështirëson tepër, ose e bën te pamundur shuarjen e këtyre zjarreve.

Lokalizimi dhe shuarja e këtij lloji zjarri mund të zgjasë për disa ditë apo madje për disa javë. Si rezultat, vetëm mënyrat indirekte të lokalizimit dhe shuarjes përdoren për zjarret e kombinuara. Më të rëndësishmet janë:

a) ***Brezat e gjerë të ndërprerjes së zjarrit;***
b) ***Zjarri i kundërt;***
c) ***Hedhja e ujit nga ajri;***
d) ***Minimi - duke përdorur eksploziv.***

Në pothuajse të gjitha mënyrat e përmendura më lart të lokalizimit dhe

shuarjes së zjarreve të kombinuara, synimi kryesor është të zbresë pikën qendrore të djegies, që gjendet në majë të kurorave, poshtë në tokë dhe të shuhet aty. Ato mund të përdoren të ndara apo mund të kombinohen në varësi nga konfiguracioni i terrenit, madhësia e pjesës se përparme të zjarrit dhe karakteristikat e tij (shpejtësia e përhapjes, intensiteti i djegies etj.), pajisjet në dispozicion, numri dhe trajnimi i zjarrfikësve etj.

a) Brezat e gjerë të ndërprerjes së zjarrit

Brezi i gjerë i ndërprerjes së zjarrit bëhet gjatë zjarrit.

Në një distancë të caktuar nga pjesa e përparme e zjarrit lënda djegëse pastrohet dhe bëhet brezi i gjerë i ndërprerjes së zjarrit (varësisht nga shpejtësia e përhapjes dhe konfiguracioni i terrenit).

Së pari, përcaktohet drejtimi i brezit të ndërprerjes së zjarrit. Më së miri është të përdoret një rrugë ekzistuese, zonë pa bimësi, një burim, një lumë apo disa barriera të tjera që tashmë ekzistojnë. Në raste të relievit të zhvilluar, pozita më e mirë për brezin e ndërprerjes së zjarrit është shpati i malit apo kodrës. Pasi të përcaktohet rruga e brezit të ndërprerjes së zjarrit, ajo shënohet ose një person shkon më përpara duke përcaktuar drejtimin, përderisa të tjerët e ndjekin atë me motorsharra apo vegla të tjera, duke shkurtuar trungjet që futen në brez.

Gjerësia e brezit të ndërprerjes së zjarrit ndryshon, por më e vogla duhet të jetë së paku dy herë më e gjerë se trungu më i lartë afër brezit ndalues. Për shembull, nëse trungjet më të larta janë 20 m, gjerësia e brezit ndalues duhet të jetë së paku 40 m, apo më shumë, nëse mendohet që është e nevojshme. Trungjet priten në atë mënyrë që të bien me majë nga zjarri, dhe me anën tjetër të tyre nga zonat që ne jemi duke i mbrojtur. Pastaj, degët shkurtohen dhe pastrohen së bashku me tërë lëndën djegëse në tokë, brenda kufijve të brezit ndalues (gjethet, degët e rëna, bari, shkurret etj.). Gjysma e lëndës djegëse të mbledhur nga zjarri hidhet në atë anë, ndërsa gjysma tjetër, nga zona që jemi duke e mbrojtur. Në këtë mënyrë, zona e pastër disa metra e gjerë, pa asnjë material djegës bëhet në mes të brezit ndalues. Në këtë zonë, duke ndjekur një linjë imagjinare në mes të brezit, gërmohet një kanal 0.5-1 m i gjerë dhe deri te toka e fortë (celina). Dheu që gërmohet hidhet në anën ku ndodhet zjarri.

Zjarrfikësit bashkë me pajisjet e tyre shpërndahen prapa këtij brezi ndalues. Kur zjarri arrin brezin, së pari kap majat e trungjeve të rëna dhe ato fillojnë të digjen intensivisht. Kjo e zvogëlon pikën qendrore të djegies që gjendet më afër tokës. Pasi majat të digjen, lënda djegëse e grumbulluar gjatë pastrimit të brezit ndërprerës dhe kërcinjve nga prerja e trungjeve, fillon të digjet, gjë e cila zvogëlon pikën qendrore të djegies, madje më afër tokës. Intensiteti i zjarrit dobësohet. Eventualisht, sipërfaqja e zjarrit arrin në kanalin e gërmuar - hendekun dhe shuhet atje.

Gjate tërë kësaj kohe, zjarrfikësit sigurohen që zjarri të mos kalojë nëpër brezin ndalues në asnjë pikë, dhe e shuajnë atë në rast se kalon. Nëse është e mundur,

rekomandohet të laget lënda djegëse e vendosur në gjysmën e brezit ndalues nga pylli që ne jemi duke e mbrojtur. Momenti më kritik është kur zjarri arrin brezin ndalues, e kështu majat e rëna fillojnë të digjen. Në këtë moment duhet pasur shumë kujdes.

Krijimi i një brez ndaluesi të gjerë për luftimin e zjarrit është detyrë shumë e gjerë, e cila duhet të kompletohet sa më shpejt të jetë e mundur. Nevojitet numër i madh i zjarrfikësve me pajisjet e duhura. Gjithashtu, rekomandohet makineri e rëndë (buldozeri), pasi do t'i bënte gjërat të kryhen më shpejt dhe më mirë.

b) Zjarri i kundërt

Në këtë mënyrë të shuarjes përdoret metoda e zjarrit. **Në një distancë të caktuar larg nga pjesa e përparme e zjarrit ndizet një zjarr i kontrolluar i drejtuar nga zjarri "kryesor",** dhe për këtë kjo metodë quhet zjarri i kundërt.

Së pari, në një distancë të caktuar nga pjesa e përparme e zjarrit, varësisht nga shpejtësia e përhapjes së zjarrit dhe konfiguracioni i terrenit, përcaktohet vija ku do të ndizet zjarri i kundërt. Pastaj, kjo vijë, disa metra e gjerë, pastrohet nga lënda djegëse, domethënë priten trungjet në këmbë, mblidhen gjethet, degët e rëna, bari etj. Lënda djegëse hidhet në drejtim të zjarrit. Në një moment të caktuar, kur krijohen kushte të favorshme, ndizet lënda djegëse e grumbulluar. Kushtet e favorshme për fillimin e një zjarri të kundërt janë atëherë kur zjarri lëviz në drejtim të kundërt me drejtimin e zjarrit kryesor. Kur ka erë që fryn përballë zjarrit kryesor, zjarri i kundërt merr drejtimin e dëshiruar. Kjo erë mund të jetë ndryshim natyral në drejtimin e erës apo mund të rezultojë nga vetë zjarri që krijon masat e ajrit, të cilat lëvizin përballë zjarrit. Kjo situatë përdoret kryesisht kur zjarri ndizet në terrene të rrafshëta.

Në rast të terreneve të pjerrëta, zjarri i kundërt përdor pjerrësinë dhe ngjitet përpjetë. Kjo përdoret kur zjarri i kundërt ndizet në një anë të shpatit të malit apo kodrës, ku zjarri kryesor është në anën tjetër, kështu që dy zjarret takohen në majë.

Kur dy zjarret ndeshen, së pari ka djegie intensive, që më vonë qetësohet dhe shuhet komplet.

Zjarri shuhet si rezultat i faktit që zjarri i kundërt ka djegur lëndën djegëse në zonën përballë zjarrit, kështu që nuk ka mbetur asgjë për tu djegur.

Kjo është mënyrë shumë efektive për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit të kombinuar, por gjithashtu është shumë e rrezikshme, pasi mund të shfaqet zjarri i r,i nëse zjarri i kontrolluar del jashtë kontrollit. Rrugët, pastrimet, prerjet (ndërtimet tashmë ekzistuese në pyje) etj., gjithashtu mund të përdoren kur shkaktohet zjarri i kundërt. Kur ndizet zjarri i kundërt, duhet të ruhet nga zjarrfikësit, të cilët do ta parandalonin zjarrin të dalë jashtë kontrollit. Ata, gjithashtu, e vrojtojnë me kujdes momentin kur dy zjarret, zjarri kryesor dhe zjarri i kundërt, ndeshen duke krijuar

djegie intensive. Rreziku i përhapjes së zjarrit, kërcimit mbi vijën e mbrojtjes është shumë i lartë në këtë pikë. Në këtë rast, zjarrfikësit ndërhyjnë dhe shuajnë zjarrin.

E tëra sa u tha më lart, na bën të kuptojmë që kjo mënyrë e lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve të kombinuara jo vetëm që është shumë efektive, por, gjithashtu, shumë e rrezikshme dhe kërkon njohuri dhe përvojë në terren, sa u takon njerëzve përgjegjës dhe zjarrfikësve.



Zjarri i kundërt

c) Hedhja e ujit nga ajri

Kur përdoret kjo mënyrë e lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve të kombinuara, përdoren aeroplanët dhe helikopterët, dhe metoda e shuarjes zakonisht është substance kimike apo ujë.

Aeroplanët mund të përdoren në dy mënyra: kur ata shuajnë zjarrin vetëm (pa pjesëmarrjen e zjarrfikësve në tokë) dhe kur ata lokalizojnë dhe shuajnë në bashkëpunim me zjarrfikësit në tokë.

Në rastin e parë, zjarret janë në fazën fillestare, domethënë në fillim, ose janë zjarre të shkallës së ulët. Kjo përdoret shumë rrallë me zjarret e kombinuara, vetëm në raste të terreneve të paarritshme.

Në rastin e dytë, mjetet ajrore përdoren në kombinim me zjarrfikësit nga toka. Aeroplanët dhe helikopterët lëshojnë ujin apo substancat kimike në pjesën e përparme të zjarrit apo në një distancë të caktuar para tij. Kur lëshohet uji apo substancat kimike mbi zjarr, shuarja dhe zvogëlimi i pikës qendrore të djegies nga maja e drurit në tokë ndodh njëherësh.

Menjëherë pasi uji hidhet mbi zjarr, zjarrfikësit në tokë afrohen dhe fillojnë ta shuajnë zjarrin, i cili në këtë pikë është zjarr tokësor. Kjo është e mundur kur zjarri nuk ka shpejtësi dhe intensitet të madh, i cili lejon aeroplanët t'i afrohen shumë afër ose mbi zjarr.

Në rastin e një zjarri të shpejtë dhe intensiv, avioni nuk mund të fluturojë afër ose sipër zjarrit, në lartësinë e kërkuar, në mënyrë që ata të hedhin ujin ose kimikatet në zonë para kreut të zjarrit. Kjo lag lëndën djegëse në zonat para kreut të zjarrit. Kur zjarri arrin lëndën e lagësht djegëse, energji-nxehja e saj të është humbur në avullimin e ujit ose kimikateve. Si rezultat, furnizuesit e zjarrit, d.m.th., pika qendrore e djegies ulet nga kurora në tokë. Në këtë moment zjarrfikësit afrohen për të shuar zjarrin.

Ka mënyra të ndryshme në të cilat uji ose kimikatet mund të çlirohen (menjëherë ose në disa faza), dhe kjo mund të bëhet nga lartësi të ndryshme. Taktikat variojnë edhe në numrin e mjeteve ajrore në dispozicion, pra nëse ato do të fikin zjarrin në një seri çdo avion pas tjetrit, ose do të shuajnë secili pjesë të ndryshme të zjarrit.

Përfshirja e mjeteve ajrore është mënyra më moderne e lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve në pyje, por është edhe shumë e shtrenjtë, për shkak të çmimit të aeroplanëve, mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të fluturimit të tyre. Përveç kësaj, pilotët dhe zjarrfikësit në terren duhet të jenë të trajnuar mirë, në mënyrë që të jenë të sinkronizuar dhe efektivë në shuarje.



Përdorimi i metodave të ajrit

d) Minimi - përdorimi i eksplozivit

Eksplozivi mund të përdoret për të bërë kanale, brez ndalues të gjerë, për të rrëzuar trungjet, domethënë pastrimi-heqja e lëndës djegëse në zonën para pjesës se përparme të zjarrit. Kjo është mënyra indirekte, në të cilën mund të përdoret eksplozivi.

Në rast të zjarreve të kombinuara, mënyra vijuese e shuarjes mund të jetë shumë efektive. Në një distancë të caktuar nga kreu i zjarrit përcaktohet një linjë dhe së bashku në këtë linjë, gërmohen ose shpohen vrima në tokë ku vendoset eksploziv. Në varësi nga gjatësia e linjës, vendosen një numër pjesësh të ndryshme të eksplozivit. Pjesët lidhen së bashku në mënyrë që ato të shpërthejnë në të njëjtën kohë. Kur kreu i zjarrit arrin vijën ku është vendosur eksplozivi, ai aktivizohet nga një distancë e sigurt. Shpërthimi krijon një kanal pa asnjë lëndë djegëse. Në të njëjtën kohë, një sasi e madhe e tokës dhe pluhurit ngrihet në ajër që mbyt zjarrin (zvogëlon praninë e oksigjenit në ajër). Për më tepër, grimcat e tokës dhe gurit bien mbi kreun e zjarrit duke varrosur lëndën djegëse (metoda e tokës). Kur përdoret kjo metodë, një tjetër fenomen mund të ndikojë zjarrin. Për shkak të shpërthimit, ajri shpërndahet befas, e cila lë më pak ajër të koncentruar në vendin e shpërthimit, i cili ul sasinë e oksigjenit në pjesën e përparme të zjarrit. Kjo ndodh shumë shpejt, por është e mjaftueshme për të mbyrtur zjarrin. Kjo mund të shuajë plotësisht zjarrin apo ta transformojë atë në një zjarr të dobët, tokësor/sipërfaqësor që mund të shuhet lehtë.

Është thënë tashmë se kjo është një metodë e rrezikshme, por edhe efektive.

Nëse do të zgjedhim këtë metodë, ne kemi nevojë për ekspertë - minatorë, eksplozivë dhe terren të sigurt. Kjo do të thotë vendosje të rojës, i cili nuk do të lejojë lëvizjen e njerëzve në zonën e siguruar për të shmangur aksidentet.

Të gjitha këto mënyra të lokalizmit dhe shuarjes së zjarreve të pyjeve (direkte dhe indirekte) mund të përdoren ndaras apo të kombinuara. Kjo varet nga pjesa e përparme e zjarrit (nganjëherë mund të jetë me dhjetëra kilometra e gjatë), konfiguracioni i terrenit, lloji i lëndës djegëse, kushtet atmosferike, numri dhe trajnimi i zjarrfikësve, pajisjet etj.

7 SKUADRA ZJARRFIKËSE

Njësia bazë për luftimin e zjarrit në pyje e kullota është skuadra zjarrfikëse. Ajo ngrihet në nivel fshati dhe anëtarët e saj janë banorë të përhershëm të fshatit. Në bazë të sipërfaqes së pyjeve e kullotave dhe mundësisë për shfaqjen e zjarreve përcaktohet numri i anëtarëve të skuadrës dhe numrit të skuadrave.

Anëtarët e skuadrës zjarrfikëse duhet të jenë persona të aftë fizikisht, të trajnuar dhe të gatshëm për të kontribuuar në shuarjen e zjarrit. Secili nga anëtarët do të ketë një rol të caktuar në shuarjen e zjarrit.

Zbatimi i rregullave të sigurisë gjatë luftimit të zjarrit duhet të ketë përparësi.

7.1 Pozicionimi i zjarrfikësve përgjatë vijës së pozitës mbrojtëse (pjesa e përparme e zjarrit)

Pavarësisht nga të njohurit e metodave dhe taktikave për lokalizim dhe shuarje të zjarreve në zona të hapura, organizimi dhe pozicionimi i zjarrfikësve gjithashtu ka një rëndësi të madhe.

Praktika tregon se edhe kur zjarrfikësit janë të trajnuar mirë dhe të pajisur mirë, nuk do të ketë sukses nëse nuk ata janë të pozicionuar si duhet. Kjo çon në çrregullim, sinkronizim të dobët, ose edhe panik. E gjithë kjo përveç kësaj komplikon lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve në zona të hapura.

Për të shmangur këtë, **zjarrfikësit mund të pozicionohen përgjatë vijës së pozitës mbrojtëse në njërën nga rrugët në vijim:**

a) ***Të ndarë;***
b) ***Në grupe;***
c) ***Progresive.***

a) ***Pozicionimi i ndarë i zjarrfikësve***

Kur përdoret kjo mënyrë, zjarrfikësit vendosen në një distancë të caktuar nga njëri-tjetri dhe secili ka një seksion të pozitës mbrojtëse ku ai/ajo shuan zjarrin. Pozita mbrojtëse zakonisht është 10-15 m e gjerë, varësisht nga zjarri. Zjarrfikësit janë të pozicionuar në këtë mënyrë në rastet e zjarreve tokësore, dhe në rastet kur

përdoren disa nga metodat e drejtpërdrejta për shuarjen. Për shembull: kur janë përdorur fshesat e çelikut, çantat e ujit, grabujat, lopatëzat etj.

Ky pozicionim, gjithashtu, mund të përdoret me metodën e dy hapave apo kur groposen kanalet, kur secili zjarrfikës ka pjesën e tij/saj dhe së bashku krijojnë të tërën.

b) ***Pozicionimi i zjarrfikësve në grupe***

Kur përdoret kjo mënyrë, zjarrfikësit pozicionohen në grupe prej 5-10, të pajisur me vegla të ndryshme. Njëri nga ata përveç shuarjes ka gjithashtu rolin e udhëheqësit të grupit.

Ky person koordinon anëtarët e tjerë të grupit dhe kontakton grupet tjera dhe zyrat qendrore. Secili grup merr një zonë të pozitës mbrojtëse që duhet të mbrohet. Gjerësia e çdo seksioni ndryshon sipas fushëveprimit. Ky pozicionim përdoret kur bëhet një brez ndalues i gjerë, krijohet zjarri i kundërt apo vija e luftimit të zjarrit.

Është me rëndësi të dihet që kur zjarrfikësit pozicionohen në këtë mënyrë, çdo zjarrfikës ka detyrën e tij/saj brenda grupit, por ata si grup krijojnë një të tërë.

c) ***Pozicionimi progresiv i zjarrfikësve***

Kur përdoret pozicionimi progresiv, puna që duhet të bëhet gjithashtu ndahet në faza.

Pozicionimi progresiv i zjarrfikësve

Çdo fazë kompletohet nga një zjarrfikës individual apo një grup zjarrfikësish. Për shembull, kur bëhet brez ndaluesi i gjerë:

- një zjarrfikës individual apo një grup zjarrfikësish së pari përcaktojnë rrugën e shuarjes së zjarrit;
- grupi tjetër pret trungjet;
- grupi prapa tyre pastron degët nga trungjet e rrëzuara;
- grupi i fundit pastron lëndën djegëse.

Kur grupi i fundit i zjarrfikësve përfundon punën tij, prapa tyre mbetet brez ndaluesi komplet.

8 ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË PARANDALIMIT/SHUARJES SË ZJARRIT NË NIVELIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE (NJVV, ADZM) LOKALE

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore ose AdZM-ja lokale duhet të planifikojë masat dhe burimet e nevojshme për të parandaluar/shuar zjarret në pyje/kullota që ndodhin në territorin e tyre në fillim të çdo viti.

Personi (at) përgjegjës nga struktura e NjVV-së dhe AdZM-ja lokale duhet të organizojnë një takim me të gjithë përfaqësuesit nga secili fshat. Në çdo fshat ekipi (et) e shuarjes së zjarrit duhet të krijohen dhe të ruhen.

Personat përgjegjës të krijojnë dhe mirëmbajnë marrëdhëniet me "Forcat e specializuara për parandalimin e shuarjen e zjarreve" (AKMC), Struktura e pyjeve pranë NjVV-së, secilin ekip zjarrfikësish brenda NjVV-së, Departamentin e Policisë etj.

Plani i masave që duhen marrë për mbrojtjen nga zjarri konsiston në tri pjesë:

Gjatë **pjesës së parë,** një rishikim i situatës me zjarret e pyjeve/kullotave në të kaluarën (numrin e zjarreve, shkaqet, zonat e djegura, pajisjet dhe mjetet e përdorura për shuarjen e zjarrit, taktikat, numri i personave të përfshirë, kushtet e motit, ora e ditës kur nisi zjarri, vendndodhja etj.). Gjatë analizës së situatës së shqyrtuar përcaktohen zonat më të ekspozuara ndaj zjarrit.

Në **pjesën e dytë,** bazuar në këto të dhëna, planifikohen masat parandaluese dhe parapërgatitore për vitin në vazhdim.

Pjesa e tretë përbëhet nga një listë e detajuar e personave që do të zbatojnë këto masa me data dhe afate të përcaktuara (infrastruktura). Për qëllime të vrojtimit të planifikuar gjatë periudhës kritike të vitit për rënie zjarri, të përgatitet një listë e hollësishme e personave, pajisjeve/mjeteve dhe automjeteve të ndara në ekipe dhe në kohë.

Procedurat që duhen ndjekur në situata të caktuara dhe harta të ndryshme (harta e lëndëve djegëse, rrugët, rezervuarët e ujit etj.) janë të përfshira si një shtojcë e këtij plani.

Objektivi i parë parandalues i NjVV-së, AdZM-së është të eliminojë ndodhjen e zjarreve person - shkaktuar në pyje.

Plani i parandalimit të zjarrit të bazohet në:

1. Parandalimi i shkaktimit të zjarrit nga personat;
2. Analiza e rreziqeve për rënien e zjarrit;
3. Edukim/sensibilizim.

Faktorët bazë që duhet të merren parasysh, janë:

1. Çfarë shkakton apo mund të shkaktojë zjarr?;
2. Ku ndodhin zjarret?;
3. Kur ndodhin zjarret?;
4. Pse fillojnë zjarret?;
5. Si fillojnë zjarret?;
6. Kush fillon zjarret?.

a. Planifikimi

Planifikimi i menaxhimit të burimeve dhe zjarrit duhet të bazohet në kuadrin ligjor, institucional dhe politikave.

Kuadri ligjor përfshin planet e menaxhimit të burimeve të gjera, shumësektoriale.

Planifikimi duhet të përfshijë:

Përcaktimin e zonave të ekspozuara ndaj zjarrit: Të përcaktohen dhe identifikohen zonat me rrezikshmëri të lartë ku zjarri mund të shkaktohet nga njeriu. Prioritet do t'u jepet aktiviteteve parandaluese në këto zona me rrezik të lartë.

Analizat e Nevojës për Personel: Stafi i menaxhimit të situatave të zjarrit pranë NjVV-së, AdZM vazhdimisht do të vlerësojë nevojën për të shtuar/pakësuar patrullat parandaluese. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet periudhës së nxehtë e të thatë të vitit dhe zonave me ndjeshmëri të lartë ndaj zjarreve.

Miratimin e Planit të Parandalimit: Kjo do të rishikohet çdo vit. Stafi për mbrojtjen nga zjarri do të jetë përgjegjës për raportimin e efektivitetit dhe kushtet/gjendjen e shenjave të parandalimit (mirëmbajtjen dhe ruajtjen).

Edukimin: Edukimi për parandalimin e zjarrit mund të marrë shumë forma, në varësi të audiencës dhe mesazhit të dëshiruar.

Kjo është zemra e çdo programi parandalimi, në kuptim të gjerë, ajo përfshin të gjitha komunikimet e përdorura për të përmbushur objektivat e programit për parandalimin e rënies së zjarrit.

Ai përfshin kontakte personale (me të gjithë personat që kryejnë aktivitete në pyje e kullota), vizita në shkolla dhe takime publike, vizita në panaire dhe veprimtari të komunitetit, shenja/sinjalistikë, postera, fletushka dhe shënime të shtypura informative, sikurse tregime dhe njoftime në radio, televizion dhe në gazetë.

Ndalimet dhe Kufizimet: Ndalimet do të rekomandohen kur zjarri paraqet rrezikshmëri për njerëzit. Sa u takon kufizimeve, ato do të jenë për kategori të caktuara. Këto përcaktohen nga drejtuesi i operacionit të zjarrit.


SKEMA E VROJTIM-SINJALIZIMIT NË RAST ZJARRI
ZJARRI
INFORMACION NGA KOMUNITETI
VROJTUESI
PATRULLA
Emri
Tel.:
Emri
Tel.:
PYLLTARI i Njësisë Administrative
Emri:
Tel.:
AKMC
Emri:
Tel.:
Drejtuesi/Stafi Operacional pranë NjVV-së
SKUADRA ZJARRFIKËSE
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:
PREFEKTURA
Struktura e Pyjeve Pranë Bashkisë
POLICIA E SHTETIT
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:
AKMC
USHTRIA
FORCAT AJRORE
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:
Emri:
Tel.:

b. Vrojtim-sinjalizimi në mbrojtjen dhe rastet e rënies së zjarrit

Në këtë pjesë do të përshkruajmë rrugën, mënyrat dhe format e marrjes dhe përcjelljes së informacionit në rast të shfaqjes së ndonjë zjarri.

Siç kemi theksuar edhe më lart, vëmendje shumë e madhe i kushtohet zbulimit të zjarrit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për këtë qëllim merren vrojtuesit dhe organizohen personat në patrulla.

Detyra e tyre është që të njoftojnë menjëherë drejtuesin (it) e operacioneve në rast zjarri. Nuk përjashtohen rastet kur zjarri vërehet fillimisht nga persona (komuniteti), që nuk janë pjesë e strukturave vrojtuese, të cilët njoftojnë menjëherë strukturat përgjegjëse qoftë edhe njësinë e AKMC-së së rrethit në nr. 128 apo Policinë e Shtetit në nr. 129.

Drejtuesi (it) i operacioneve në rast zjarri, menjëherë pasi merr njoftimin për rënien e zjarrit, organizon punën për dërgimin e skuadrës (ave) zjarrfikëse dhe mjeteve mbështetëse në vendin e zjarrit dhe ndjek hap pas hapi ecurinë e punës për kontrollimin dhe shuarjen e zjarrit.

Sipas nevojës që paraqitet, njoftohet Struktura e Pyjeve në Bashki, Strukturat e AdZM-së, Prefektura (AKMC), ushtria apo edhe njësitë e specializuara të forcave ajrore.

c. Operacioni në rast zjarri

Pas marrjes së informacionit për rënien e zjarrit nga burimet e informacionit, **drejtuesi i operacionit** për shuarjen e zjarrit përcakton personat dhe mjetet e nevojshme për ndërhyrje.

Jep udhëzimet e nevojshme dhe fillon puna për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Njëkohësisht njofton Strukturën e Pyjeve në Bashki, AdZM-në, AKMC-në, Policinë e Shtetit, Prefekturën, duke ditur që paraprakisht kanë nënshkruar një program bashkëpunimi për mbrojtjen nga zjarret.

Gjatë luftimit për shuarjen e zjarrit, drejtuesi i operacionit **informohet hap pas hapi** mbi ecurinë situatës së krijuar dhe parashikon masa dhe mjete shtesë (nëse zjarri përparon).

Drejtuesi parashikon edhe dërgon në terren të gjithë personelin dhe mjetet mbështetëse. Skuadrat zjarrfikëse duhet të jenë të kujdesshme dhe të veprojnë me profesionalizëm në përhapjen dhe shuarjen e zjarrit.

Në rastet kur shuarja e zjarrit nuk përballohet nga forcat dhe mjetet në dispozicion, kërkohet ndihmë nga Prefektura (AKMC). Në rastet ekstreme kërkohet edhe ndërhyrja e ushtrisë (në bazë të ligjit ekzistues është institucioni i Prefektit ai që e ka këtë të drejtë).

Drejtuesi i operacionit duhet të parashikojë masa dhe mjete për shpëtimin e jetëve të banorëve që janë në afërsi të zjarrit, dhe personave që punojnë për shuarjen e tij.

SKEMA OPERACIONALE



8.1 Përfshirja e komunitetit në parandalimin e zjarreve në pyje

Siç kemi theksuar më parë, shumica e zjarreve të pyjeve/kullotave janë të shkaktuara nga veprimtaritë e ndryshme njerëzore, kështu parandalimi dhe kontrolli i tyre duhet të përfshijë njerëz në nivel lokal.

Përfshirja e komunitetit mund të luajë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret në pyje/kullota.

Thënia "Parandalimi është më i mirë sesa shërimi" është më se me vend për të theksuar rolin e komuniteteve të fshatrave në parandalimin e zjarrit. Planifikimi i duhur është i domosdoshëm për parandalimin e zjarrit. Vetëm kur komunitetet lokale e dinë se do të përfitojnë nga mbrojtja e pyjeve të tyre, ata do të bëjnë gjithçka për të parandaluar zjarret në pyje/kullota.

Menaxhimi i zjarrit bazuar te komuniteti duhet të mbështetet shumë në lidhjet pozitive mes njerëzve në hapësirën rurale dhe pyjore të tyre. Besimi i ndërsjelltë dhe mbështetja publike duhet të krijohet nga metodat pjesëmarrëse/përfshirëse.

Këndvështrimi i njerëzve mbi dukurinë e shfaqjes së zjarreve të pyjeve/kullotave është me rëndësi jetike në vlerësimin e ndikimit të përpjekjeve të komunitetit në kontrollin e zjarrit.

Përfshirja e komuniteteve në aktivitetet e kontrollit të zjarrit është e domosdoshme përmes fushatave të ndërgjegjësimit, burimeve alternative dhe aktiviteteve.

8.1.1 Procesi i Planifikimit të Menaxhimit të zjarrit me pjesëmarrje të komunitetit

Planifikimi për menaxhimin e zjarrit me komunitetin duhet të drejtohet brenda një strukture, metode të perbashkët menaxhimi të përgjithshëm. Kjo është niveli i mirëkuptimit dhe marrdhënies ndërmjet komunitetit, liderëve lokalë dhe stafi i pyjeve në bashki është mjaftueshmërisht në nivel për të mbështetur procesin e menaxhimit të zjarrit në bashkëpunim midis tyre. Nëse jo, atëherë fillimisht duhen forcuar këto aspekte.

Hapat për të zhvilluar një proces të tillë, mund të jenë:

- Rritja e ndjeshmërisë së komunitetit dhe krerëve tradicionalë;
- Realizimi i një analize të palëve që kanë lidhje me zonën pyjore - përdoruesit dhe përfituesit;
- Realizimi i një vlerësimi të rrezikut të zjarrit dhe hartografimi përmes një vlerësimi dhe përshkrimi të përbashkët;
- Analizimi së bashku i të dhënave për të zhvilluar planin e menaxhimit të zjarrit me pjesëmarrje të komunitetit.

9 SIGURIA

Secili e di se sa i rrezikshëm është zjarri. Gjithmonë ekziston rreziku për një aksident.

Disa këshilla për të parandaluar aksidentet gjatë shuarjes së zjarreve dhe operacioneve të caktuara të djegies me paramendim. Përveç të qenit i kujdesshëm, zjarrfikësit duhet të kenë disa masa mbrojtëse të marra, si:

Para se zjarrfikësit të fillojnë për të bërë punën e tyre, ata duhet të sigurohen nëse janë duke punuar të veshur me rrobat e duhura.

9.1 Pajisjet mbrojtëse të zjarrfikësve

Personat në terren gjatë operacioneve të luftimit të zjarrit mund të kërkojnë pajisje personale mbrojtëse të veçanta që duhet të kenë qenë identifikuar në vlerësimin e rrezikut.

Megjithatë, përdorni për operacionet e përgjithshme të luftimit të zjarrit:

1. Një kostum pambuku me ngjyra të ndezura rezistent ndaj zjarrit është i rekomanduar, si edhe një copë mbrojtëse qafe. Mos vishni rroba sintetike ose najloni.
2. Çizme mbrojtëse me mjet shtrëngimi të mirë dhe mbështetëse për kyçin e këmbës.
3. Doreza të përshtatshme mbrojtëse (josintetike, p.sh., lëkurë).
4. Helmetë sigurie, në qoftë se identifikohet se kërkohet nga vlerësimi i rrezikut.
5. Mbrojtje e syve, nëse identifikohet siç kërkohet nga vlerësimi i rrezikut, për të parandaluar dëmtimin e syve nga grimcat dhe prushi.
6. Mbrojtje dëgjimi ku niveli i zhurmës është i lartë.
7. Ujë për konsum personal dhe për të larë çdo djegie.
8. Një kuti e specializuar e ndihmës së parë për djegie duhet të jetë në dispozicion në vend dhe secili person duhet të mbartë një çantë të ndihmës së parë personale për plagosjet jo nga djegia.

9.2 Këshilla të përgjithshme

- Duhet të jesh i përgatitur moralisht në kryerjen e operacioneve me kërkesa fizike për periudha të gjata. Punëtorët duhet të jenë të fizikisht dhe të aftë për kryerjen e detyrave që priten të kryen.
- Bashkëveprimi me kolegët për shenja stresi për shkak të punës fizike të kërkuar dhe afërsisë me zjarrin. Gjithashtu, shiko për djegiet nga nxehtësia rrezatuese.
- Të jesh veçanërisht i vetëdijshëm për rreziqet e pranishme gjatë kalimit të terrenit në kushtet e shikimit të reduktuar, për shkak të dritës së paktë ose tymit.
- Shikoni për faktorë (ose kombinime të faktorëve) të cilët mund të krijojnë ndryshime të papritura në sjelljen e zjarrit, duke përfshirë:
  - moti (p.sh., ndryshim të drejtimit dhe shpejtësisë së erës);
  - lëvizjen e zjarrit mbi shpatet e pjerrëta;
  - natyrën dhe sasinë e lëndës djegëse në dispozicion të zjarrit.
- Mbani komunikimin me kolegët dhe mbikëqyrësit tuaj.

a) ***Mjetet, pajisjet dhe makineritë***

- Mund të jetë një shumëllojshmëri e gjerë e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive (përfshirë automjetet dhe helikopterët) në përdorim për terrenin e zjarrit. Operatorët kanë të ngjarë të jenë duke punuar nën presion, nganjëherë në shikueshmëri të dobët, ose me zhurmë të konsiderueshme në sfond, kështu që tregoni kujdes të veçantë nëse iu afroheni atyre.
- Sigurohuni që ju dhe kushdo, se ju jeni përgjegjës për të, jeni të vetëdijshëm për zonat e sigurisë që zbatohen për mjetet, pajisjet dhe makineritë në vend.

b) Planet dhe hartat e zjarrit

- Sigurohuni që keni lexuar dhe kuptuar planin e zjarrit që ju jeni njohur me procedurat që duhen ndjekur në një rast urgjence.
- Sigurohuni që keni parë dhe kuptuar çdo hartë zjarri, duke përfshirë çdo simbol të përdorur.

c) Përgatitja për luftimin e zjarrit

- Kontrolloni tërësisht të gjitha pajisjet personale mbrojtëse, mjetet, pajisjet dhe makineritë për të siguruar se ato janë në gjendje pune. Vendos pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale para se t'i afrohesh zjarrit.
- Zgjidhni mjetet për llojet e pritshme të lëndëve djegëse dhe sjelljen e zjarrit. Gjithashtu, merrni mjetet për çdo fazë të shuarjes së zjarrit në vendin e zjarrit.

d) Luftimi i zjarrit

- Kontrolloni që ngarkesa totale të mos tejkalojë kapacitetin mbajtës të makinës suaj, dhe të jenë të përshtatshme për terrenin e pritshëm.
- Shënoni rrugët e sigurta për në dhe nga vendi i zjarrit për Shërbimet e Zjarrit dhe Shpëtimit dhe personelin tjetër.
- Merrni informacion mbi zjarrin dhe vlerësoni vetë sjelljen e zjarrit para se t'i afroheni atij. Kur të jetë e përshtatshme jepni informacion për mbikëqyrësit tuaj ose personelit të shërbimit të zjarrit.
- Ku është e përshtatshme, diskuto njohuritë tuaja lokale të rrugëve të hyrjes, pikat e ujit, ndërprerëset potenciale të zjarrit etj., me eprorin tuaj ose njerëzit në krye të operacionit.
- Sigurohuni që ju keni marrë udhëzime mbi rolin tuaj në aktivitetet për luftimin e zjarrit.
- Sigurohuni që ju jeni regjistruar dhe çregjistruar nga njerëzit përgjegjës për menaxhimin e zjarrit, kur hyni apo largoheni nga terreni i zjarrit.
- Luftoni zjarrin, por gjithmonë vendosni sigurinë të parën.
- Veproni brenda nivelit tuaj të pranuar të autoritetit dhe përgjegjësisë.
- Operoni brenda aftësive tuaja fizike, mbani një ritëm të qëndrueshëm të punës, merrni pushim dhe pini shumë ujë.
- Mbani një qëndrim të balancuar kur jeni duke përdorur mjetet e dorës dhe shmangni terrenin e vështirë ose pengesa të tjera, sidomos kur mbani peshë.
- Identifikoni dy rrugë kryesore të përshtatshme largimi nga zjarri.
- Të mbani një distancë të sigurt pune nga kolegët kur përdorni mjete dore, duke përfshirë rrahës zjarri, kazma dhe sëpata.
- Siguroni zonat e sigurisë për pajisje, duke përfshirë sistemet me presion të lartë mjegullnaje, motorsharrat dhe zinxhirët e traktorëve, të jenë të pastër para se të veprojnë.
- Gjithmonë qëndro të paktën 40 m larg nga helikopteri, veçanërisht gjatë ngritjes apo uljes. Afroju një helikopteri vetëm në qoftë se një sinjal i qartë është dhënë nga piloti. Kur helikopterët janë ujë-bombardues, i gjithë stafi në terren duhet të jetë së paku 10 metra jashtë zonës së synuar.
- Shmangni të punuarit në tym të dendur kudo që të jetë e mundur, pasi ai mund të shkaktojë iritim të syve, hundës, fytit dhe mushkërive, si dhe të rrisë rrezikun e të humburit dhe çorientimit.
- Shmangni të punuarit nën linjat e tensionit.
- Sigurohuni që zjarri është shuar para se të lëvizni për në detyrën tjetër, apo sigurohuni që mbikqyrësi juaj është vënë në dijeni se zjarri nuk është shuar në zonën tuaj, nëse ju është dhënë udhëzimi për të lëvizur.

9.3 Disa konsiderata të tjera

Nëse operacioni fillestar i luftës kundër zjarrit është i pasuksesshëm, operacionet e zgjeruara do të jenë të nevojshme. Këto mund të përfshijnë:

- punë me turne;
- burime shtesë për luftimin e zjarrit;
- furnizimin me ujë të pijshëm;
- furnizimin me ushqim;
- pajisjeve të ndriçimit (përfshirë pishtarë/fenerë);
- pajisje shtesë komunikimi (duke përfshirë edhe bateritë dhe/ose objektet e rimbushjes = ushqyesit).

Pas zjarrit

- Kontrolloni veten dhe kolegët tuaj për ndonjë plagosje. Sigurohuni që të gjithë kolegët tuaj janë të pranishëm dhe raportoni çdo person që mungon apo të plagosur te mbikëqyrësit tuaj.
- Mblidhni të gjitha mjetet dhe pajisjet para largimit nga vendi i zjarrit. Siguroni gjërat dhe transportojini ata përsëri në depo.
- Kontrolloni renditjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve para magazinimit. Menjëherë zëvendësoni apo riparoni artikujt që janë tejpërdorur ose të dëmtuar. Ju mund të keni nevojë për ato përsëri shumë shpejt, nëse zjarri riaktivizohet apo bie diku tjetër.
- Ji i përgatitur për të marrë pjesë në një përmbledhje. Kujtesa juaj e ngjarjeve, kohëzimet, operacionet e ndërmarra, burimet e përdorura dhe sa mirë kanë shkuar gjërat, e gjitha do të jetë e dobishme.

Gjatë një situate zjarri, edhe zjarrfikësit që janë të trajnuar mirë/me përvojë, mund të pësojnë aksident. Zjarrfikësit mund të lëndohen dhe kanë nevojë që shërbimet e emergjencës të arrijnë tek ata. Masat paraprake, paraplanifikimi dhe procedurat e emergjencës duhet të jenë në vend. Ne duhet të sigurohemi që këto shërbime janë në dispozicion në kohën më të shkurtër.

Ekziston një nevojë për të përfshirë emergjencat mjedisore dhe të tjera në kuadër të procesit të planifikimit.

Këtu janë disa nga masat paraprake

Shmangni të punuarit vetëm. Në qoftë se është e nevojshme, ju duhet të bëni marrëveshje për dikë për t'ju kontrolluar ju në intervale të rregullta kohe. Sa më i madh rreziku, aq më të shpeshta duhet të jenë kontrollet. Si kërkesë minimale, gjithmonë informoni kontaktuesin tuaj kur fillon dhe mbaron puna.

Nëse ju jeni pjesë e një skuadre të shpërndarë nëpër një zonë, të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të bien dakord për të lënë orare të caktuara takimi gjatë gjithë ditës.

Mbaj çantë personale të ndihmës së parë me vete kur je në vendin e punës. Ajo duhet të përmbajë të paktën një fashë të madhe për plagët, një palë doreza plastike etj.

Zjarrfikësit dhe personat e përfshirë në luftën kundër zjarrit të pyjeve duhet të vlerësojnë kërkesat e ndihmës së parë të punës së tyre. Sigurohuni që personeli përkatës i trajnuar i ndihmës së parë është i mjaftueshëm (personat e ndihmës së parë) dhe lehtësitë në mënyrë që ndihma e menjëhershme të jetë në dispozicion të viktimave të sëmundjes apo lëndimit, dhe se një ambulancë apo ndihmë tjetër profesionale, mund të thirret pa vonesë. Vlerësimi duhet të identifikojë se cilat sendet duhet të jenë në çantën e ndihmës së parë.

- Vlerësimi i ndihmës së parë duhet të marrë në konsideratë:
  - natyrën e punës;
  - historinë e kaluar dhe pasojat e aksidenteve;
  - natyrën dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore;
  - largësinë e vendit nga shërbimet e emergjencës, duke përfshirë vendndodhjen, kushtet e terrenit dhe motit;
  - të punuarit në vende të përbashkëta ose shumë vende;
  - festat dhe mungesat e tjera të personave të ndihmës së parë;
  - prania e të trajnuarve dhe publikut.

9.4 Planifikimi përpara

Që çdo procedurë urgjence të funksionojë mirë, është me rëndësi që të gjithë operatorët dhe menaxherët të jenë në dijeni të procedurave dhe të kenë pasur mundësi për t'i provuar ato.

Parashiko problemet që do të ketë në marrjen e një viktime, p.sh., ngjitje në drurë dhe nevojën për shpëtim nga ajri ose lirimi i një viktime që është bllokuar nën drurë ose një pajisje të rëndë. Identifikimi i personelit dhe pajisjet që duhet të jenë në vend, dhe vendos si të tjerët të mund të hyjnë shpejt nëse bëhet e nevojshme.

Identifiko rreziqet mbi kokë dhe shërbimet që ekzistojnë nën tokë në vendin e punës, si p.sh.: linjat sipërfaqësore/nëntokësore të tensionit etj. Organizoni çdo hollësi kontakti emergjence dhe procedurat e evakuimit që mund të jetë e nevojshme.

Të jenë të vetëdijshëm se një rënie benzine, nafte, ureje apo pesticideve mund të shkaktojnë dëm në mjedis (veçanërisht të bimëve ujore dhe kafshëve) dhe ndot furnizimet me ujë të pijshëm. Procedurat e urgjencës duhet të vihen në vend dhe ndiqen në qoftë se ka një përhapje. Ata duhet të përfshijnë të dhënat e kontaktit,

çfarë duhet futur në kutinë e ndihmës së shpejtë, si ta përdorin atë dhe ku duhet të vendoset.

Procedurat e urgjencës duhet të testohen, vlerësohen dhe modifikohen, siç është e nevojshme, për të siguruar se ata janë në gjendje pune.

Procedurat e urgjencës

Nëse është një rast urgjent, sigurohuni që vendi është i sigurt për ju, të dëmtuarin dhe çdo person tjetër në zonë. Shiko për drurë të varur/rrëzuar, pjesë të rrezikshme të makinerive, kabllo të energjisë elektrike dhe tensionit të lartë etj.

Vendos në vend një sistem për të kontaktuar me shërbimet e urgjencës, kompanitë e gazit/energjisë elektrike/ujësjellësit dhe agjencitë e mjedisit sipas nevojës. Sigurohu që sistemi është kuptuar qartë nga të gjithë njerëzit që punojnë në vend. Identifiko zonat ku nuk mund të komunikohet me radio dhe telefoni celulare. Shërbimet emergjente mund të kontaktohen duke përdorur një telefon celular (128 ose 129 për Shqipërinë).

Sigurohu që dini vendndodhjen tuaj. Ji në gjendje t'iu ofrosh shërbimeve të urgjencës informacionin e nevojshëm për të gjetur vendin, p.sh., pika e hyrjes nga rruga kryesore për vendin tuaj në pyll ose tokë pyjore. Nëse është e mundur, dërgo dikë që të takojë shërbimet e urgjencës në një pikë të caktuar takimi për t'i udhëhequr ata deri në vend.

10 ANEKSE

10.1 Aneksi 1 Baza Ligjore

LIGJ
Nr. 45/2019
PËR MBROJTJEN CIVILE

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Fatkeqësi natyrore" janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
2. "Fatkeqësi të tjera" janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

Seksioni II
Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile

Neni 27
Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile

Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile, në nivel vendor, janë:
a) prefekti i qarkut;

b) komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
c) bashkitë;
ç) strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.

Neni 28
Prefekti i qarkut

1. Prefekti i qarkut ka rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku.
2. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për prefektin e qarkut, prefekti i qarkut ka dhe këto detyra:
   a) të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të nenit 65 të këtij ligji;
   b) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryen vlerësimin e risqeve në territorin e qarkut përkatës, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku, i cili i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi;
   c) koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe pas ezaurimit të të gjitha kapaciteteve brenda qarkut për përballimin e emergjencës civile ose fatkeqësisë, i kërkon ndihmë për ndërhyrje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
   ç) bashkëpunon me bashkitë për realizimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në qark, si dhe për informimin e publikut e të komunitetit të rrezikuar nga fatkeqësitë në lidhje me to;
   d) harton, miraton dhe përditëson Planin për Emergjencat Civile në qark dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi;
   dh) grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe informon në mënyrë të vazhdueshme Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
   e) siguron funksionimin e sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut dhe informon në kohë komunitetin e rrezikuar, prefektët e qarqeve fqinje, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fatkeqësitë në territorin e qarkut;

ë) merr masat e nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë;
f) koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive në nivel qarku;
g) përcakton prioritetet për nevojat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, investimet emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë;
gj) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson, si edhe shkëmben informacione me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe, sipas rastit, me prefektët e qarqeve fqinje;
h) koordinon forcat operacionale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive dhe cakton drejtuesin e operacionit në nivel qarku;
i) bashkëpunon me bashkitë e qarkut dhe me prefektët e qarqeve fqinje, në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë;
j) angazhon kapacitetet brenda qarkut për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë, si edhe qytetarët, sipas përcaktimeve të nenit 26 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
k) në rast emergjence civile apo fatkeqësie, ka për detyrë të realizojë përhapjen dhe shkëmbimin e informacionit me AKMC-në, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve të tjera të prekura ose të rrezikuara, si dhe të promovojë e të koordinojë marrjen e masave të nevojshme për përballimin e situatës, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve urgjente, aktivizimin e institucioneve dhe administratave për ndërhyrje specifike;
l) kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
ll) i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

Neni 30
Bashkitë

Bashkitë kanë këto detyra:
a) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi;

b) informojnë publikun dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë;
c) hartojnë dhe rishikojnë strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
ç) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi;
d) organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre;
dh) sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre dhe informojnë në kohë komunitetin e rrezikuar, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektin e qarkut për fatkeqësitë në territorin e qarkut;
e) sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive;
ë) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
f) kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme prefektin e qarkut, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
g) caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie për përballimin e fatkeqësisë në territorin e saj;
gj) kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre;
h) bashkëpunojnë me bashkitë fqinje në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë;
i) mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë;
j) aktivizojnë kapacitetet e subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë bashkitë fqinje dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësive;
k) mbajnë në gatishmëri infrastrukturën e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre.

Seksioni III
Strukturat operacionale të mbrojtjes civile

Neni 32
Strukturat operacionale të mbrojtjes civile

Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, janë:

a) Forcat e Armatosura;
b) Policia e Shtetit;
c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
ç) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
d) Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.

Neni 34
Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

1. Në kuadër të sistemit të mbrojtjes civile, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë këto detyra:
   a) angazhohen në operacione të ciklit të menaxhimit të fatkeqësive, nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe komunitetin;
   b) zhvillojnë kapacitete ndërvepruese, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturatkolektive të sigurisë euroatlantike për përballimin e fatkeqësive.
2. Struktura të posaçme të kërkim-shpëtimit të Forcave të Armatosura angazhohen në kryerjen e operacioneve për përballimin e fatkeqësive.
3. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kapacitetet e Forcave të Armatosura angazhohen në zbatim të detyrave të Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile.
4. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit.

Neni 35
Policia e Shtetit

1. Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit, sipas planeve të hartuara më parë, si dhe planeve të përbashkëta

me institucionet e tjera për çështje të mbrojtjes civile.
2. Detyrat e saj përfshijnë mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.
3. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre.

Neni 36
Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

1. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme dhe vepron për shuarjen e zjarreve, për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve në zonat e emergjencës civile dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
2. Në rastet kur shërbimi zjarrfikës merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, personeli i shërbimit zjarrfikës komandohet nga drejtuesit e tyre përkatës.

Neni 37
Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor

1. Veprimtaria e Shërbimit të Urgjencës Mjekësore në fushën e mbrojtjes civile rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin e urgjencës mjekësore dhe për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Shërbimi i Urgjencës Mjekësore është pjesë përbërëse e forcave operacionale dhe vepron për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës civile dhe për transportimin e të dëmtuarve për në qendrat spitalore.

Neni 38
Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile

1. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë kontribuon vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe në zvogëlimin e pasojave të tyre.
2. Vullnetarët mund të ofrohen individualisht apo në grupe të organizuara, si struktura jofitimprurëse, por në të gjitha rastet, në varësi të situatave të krijuara dhe të nevojave të sistemit të mbrojtjes civile, detyrat e tyre caktohen nga

institucionet apo strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.

3. Trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 58
Detyrimet e shtetasve

Në kuadër të mbrojtjes nga fatkeqësitë, çdo shtetas është i detyruar:

a) për çdo fatkeqësi të identifikuar nga ana e tij, të informojë menjëherë numrin e unifikuar të thirrjeve emergjente 112, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, numrat e tjerë të emergjencave, si dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme;të respektojë udhëzimet, të zbatojë urdhrat e masat dhe të ndjekë procedurat e kërkuara nga strukturat e mbrojtjes civile;
b) të marrë masa për mbrojtjen vetjake dhe mbrojtjen e personave të tjerë, jeta apo shëndeti i të cilëve është në rrezik, duke mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e tij;
ç) për qëllime të mbrojtjes civile, me kërkesë të drejtuesve të institucioneve apo të strukturave të mbrojtjes civile, të lejojë kryerjen e punimeve në pasurinë e paluajtshme, si dhe tëvendosë në dispozicion mjediset dhe mjetet private.

Neni 61
Detyrimet e subjekteve private

3. Kur ato ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullosor kombëtar, janë të detyruara të mbrojnë këto sipërfaqe nga zjarret, duke hartuar dhe përditësuar plane për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë apo bashkive dhe prefekturës apo prefekturave, si edhe rregullore të brendshme lidhurme këtë çështje.

Ligj Nr. 57/2020,
datë 30.04.2020: "Për Pyjet"

Neni 17
Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet

1. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ka këto detyra:

a) ngre dhe mirëmban regjistrin e fondit pyjor kombëtar në bashki. Mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private, përgjigjet për ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor dhe mban të dhëna të sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyjet e bashkisë e ato private, brenda territorit administrativ të bashkisë;

Neni 22
Infrastruktura në fondin pyjor kombëtar

5. Në raste zjarresh, katastrofash natyrore ose manovrash ushtarake, lejohet, pa asnjë kufizim, përdorimi i infrastrukturës rrugore në fondin pyjor kombëtar.

Neni 27
Përfitimet nga shfrytëzimi i produkteve drusore

2. Vëllimi i materialit drusor, që do të shfrytëzohet çdo vit, planifikohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, bazuar në planet e mbarështimit. Pjesë e këtij vëllimi është edhe vëllimi i materialit drusor me vlerë ekonomike, i planifikuar nga prerjet kulturore, si edhe nga dëmtimet si rezultat i katastrofave natyrore ose zjarret.

Neni 30
Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar

1. Mbrojtja e pyjeve përfshin masat parandaluese, vëzhgimin e situatës në pyje dhe evidentimin e dëmeve apo sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve, që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar, të tilla si:
   a) prerjet ose kullotja pa leje, dëmtimi i fondit pyjor kombëtar (përfshirë infrastrukturën
   pyjore dhe veprat ujore), sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi;
   b) lëndët e gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit;
   c) çdo veprimtari që cenon ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore, ose

dëmton të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, e realizuar nga cilido institucion shtetëror, qendror apo vendor, personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj.

2. Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, është detyrë e përhershme e strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor, e pronarëve privatë, e subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara nga ligje të tjera.
3. Ndalohet ndezja e zjarreve në fondin pyjor kombëtar, publik apo privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre.
4. Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar:
   a) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, si dhe pronarët privatë organizojnë sistemin e vrojtim-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
   b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;
   c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre;
   ç) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje. Këto fushata organizohen në nivel kombëtar edhe nga ministria dhe agjencia.
5. Për shuarjen e zjarreve në pyje:
   a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe pronarët privatë ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me strukturat e tjera shtetërore sipas detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni

në fuqi. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përdoruesit e pyjeve përmes përfaqësuesve të tyre lokalë dhe pronarët privatë mbajnë të dhëna statistikore për zjarret në pyjet brenda territoreve të tyre dhe raportojnë pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) shpenzimet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura ose subjekti që ka në pronësi pyllin dhe nga buxheti i shtetit në rastin e një prone me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

6. Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 36

Kundërvajtjet administrative në fondin pyjor kombëtar

4. Dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë shkeljet e mëposhtme:
   b) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara apo në fondin pyjor kombëtar, publik dhe privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre;
6. Dënohen me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë shkeljet e mëposhtme:
   a) eksporti i lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimenteve që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, apo të tjera produkte, gjithmonë kur këto ndalohen specifikisht të eksportohen me ligj apo vendim të Këshillit të Ministrave;

10.2 Aneksi 2 Patrulla e Parandalimit të Zjarrit në Pyje

PATRULLA E PARANDALIMIT TË ZJARRIT NË PYJE

Efektiviteti i patrullave të tilla është kryesisht në zjarret e ndezura nga njerëzit. Ajo duhet të jetë e dukshme në ato zona.

Ajo duhet të vlerësojë situatën e zjarrit:

- cili është problemi aktual;
- arsyeja specifike e zjarrit;
- madhësia e zjarrit;
- vendi, ku ndezje të tjera mund të ndodhin, kush është përgjegjës;
- kur ndodhin incidente.

Çfarë duhet të përfshijë planifikimi i patrullimit?

1. Zonat prioritare të patrullimit;
2. Grafikun e patrullave;

3. Aktivitetet e patrullës;
4. Oraret e patrullimit;
5. Personelin e patrullës;
6. Raportimin dhe vlerësimin.

Identifikojë dhe kontrollojë zonat me rrezik të madh si potencial për ndezje, materialet më të rrezikshme dhe terrenin, potenciali më i madh i dëmeve dhe t'i vlerësojë ato.

Patrullat duhet të veprojnë në kohë/orë të ndryshme. Orari duhet të jetë i adaptueshëm.

Fundjavët dhe festat, stinët e gjuetisë dhe peshkimit, përdorimin intensiv të njeriut dhe kufizimet e ndalimet duhet të merren në konsideratë. Zjarre ekzistuese, kushtet e motit dhe rritja e kushteve të tjera, të cilat mundësojnë ndezjen duhet të merren në konsideratë gjithashtu.

Identifikimi i kushteve që krijojnë mundësi për ndezjen e zjarrit. Kuptojnë dhe aplikojnë veprimet e nevojshme. Gjithmonë të komunikojnë me eprorët e tyre ose mes njëri-tjetrit.

Personeli duhet të veshë uniformat, të jetë i besueshëm, të marrin iniciativa, të ketë besim dhe të jetë i gatshëm për të kryer detyrën e vet.

Ka lloje të ndryshme të patrullave:

- Motorizuar;
- Në këmbë;
- Ajër;
- Në kuaj.

Siguria e personelit të patrullës duhet të jetë një prioritet.

Gjithë personeli duhet të jetë i trajnuar dhe i aftë për të përmbushur të gjitha detyrat.

Përdor pajisje dhe mjete të përshtatshme dhe mirëmbaji ato.

Aktivitetet e patrullës janë:

- Kontakte individuale;
- Kontakte në Grup;
- Kontakte Prioritare;
- Kontakte Publike;
- Zbatimi i Ligjit;
- Instalimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës etj.

Plani i patrullimit duhet të përfshijë:

- Datën;
- Orën;
- Tipin e kontaktit;
- Vendndodhjen;
- Shënimet;

- Shkeljet/paralajmërimet;
- Fotografitë etj.

Është me rëndësi thelbësore që të gjitha aktivitetet e patrullës të dokumentohen, kështu që mund të përdoren në të ardhmen.

Ditari i kontakteve ditore për parandalimin e zjarreve

Njësia: _____ Dorëzuar nga: _____

Nr.	Data	Ora	Lloji kontaktit / nr. i licensës	Vendndodhja	Shënime

10.3 Aneksi 3 Dhjetë urdhrat standard në rast zjarri

DHJETË URDHRAT STANDARD NË RAST ZJARRI

1. Informohu mbi kushtet dhe parashikimin e motit.
2. Informohu mbi kushtet e zjarrit në çdo moment - vëzhgo veten, përdor vrojtuesit.
3. Bazo të gjitha veprimet tuaja në sjelljen aktuale dhe të parashikuar të zjarrit.
4. Përcakto rrugët e ikjes/largimit dhe bëji të njohura për të gjithë.
5. Vendos njoftime rreziku ku ekziston një mundësi rreziku.
6. Kini kujdes, ruani qetësinë, mendoni qartë, veproni me vendosmëri.
7. Ruaj komunikimin me njerëzit tuaj, shefin dhe forcat e tjera.
8. Jep udhëzime të qarta dhe sigurohu që ato të kuptohen.
9. Ruaj kontrollin e njerëzve tuaj në çdo kohë.
10. Lufto zjarrin në mënyrë agresive, por garanto sigurinë më parë.

10.4 Aneksi 4 Largimi i komponentit të zjarrit dhe shuarja e tij

Komponenti i zjarrit	Teknika e largimit/heqjes	Zbatueshmëria sipas madhësisë së llojit të zjarrit
Lënda djegëse	Hiq lëndën djegëse me **djegie të kontrolluar/përcaktuar.** Gjurmët **tokë-zhveshur** mund të krijohen duke përdorur makineri. Në mënyrë të veçantë, lënda djegëse është lëvizur nga shtyrësit ose nga shtypësit.	Këto teknika luftimi indirekte mund të jenë të përshtatshme për zjarret me intensitet të vogël dhe të madh, nëse ndërprerësja e zjarrit është mjaftueshëm e gjerë. Në shqopë dhe bar, gjerësitë prej 5 m të ndërprëseve të zjarrit mund të jenë të mjaftueshme në disa kushte. Gjerësia prej 10 m e ndërprerëses së zjarrit do të përmirësojë normat luftimit me sukses të zjarrit.
	Gjurmët e bimësisë së prerë në shqopë mund të alternojnë karakteristikat e lëndëve djegëse që të ndërpresin djegien për një periudhë të kufizuar kohe në disa kushte.	Gjerësitë e gjurmës deri në 15 m, mund të kërkohen pavarësisht nga gjatësia e pritshme e flakës. Vegjetacionit duhet të hiqet për të përmirësuar efektivitetin brezave të ndërprerjes së zjarrit.
Nxehtësia	Nxehtësia mund të reduktohet duke **aplikuar ujin.** Pikat e imëta të ujit (mjegullnaja) janë më efikase për heqjen e nxehtësisë se rrëketë e rrëmbyeshme të ujit.	Shuarje zjarri nga rrëketë e rrëmbyeshme të ujit standarde është një teknikë e përbashkët dhe mund të përdoret në të gjitha llojet e zjarrit në pyje/shkurre.
	Lëndët djegëse mund të njomen në mënyrë efektive nga shtrirja e ulët dhe e mesme e **rrëkeve të shkumës** dhe **"uji i lagësht".** Shtimi i **koncentratit të shkumës** në ujë, ul tensionin në sipërfaqe të ujit, gjë që përmirëson depërtimin e ujit në lëndët djegëse.	Sistemet mjegullnajë/shiu janë efektive më shumë për zjarret në shqopë dhe bar. Sistemet mjegullnajë/shiu janë më pak të përshtatshme për zjarret intensive në kushte me erë të fortë.
	Kruajtësit ndajnë lëndën djegëse nga nxehtësia.	Rrëke shkume me përhapje të ulëta janë shumë efektive në e mposhtjen e zjarreve me intensitet të lartë.
Oksigjen	Furnizimi me oksigjen mund të ndërpritet duke përdorur sistemet e shuarjes **rrahës, mbulim me dhe** dhe duke përdorur **shkumë** direkt (përhapje e ulët) dhe indirekt (përhapje e mesme e gjurmëve të shkumës).	Sistemet e luftimit të drejtpërdrejtë janë më pak të përshtatshme për zjarret më intensive. Rrahësit mund të përdoren për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të ujit në formë shiu në kushte me zjarr më të fortë.
		Sistemet e shkumës mund të përdoren në mënyrë efektive në kushtet e duhura për të ndërprerë furnizimin me oksigjen.

10.5 Aneksi 5 Intensitetet e linjës së zjarrit lidhur me vlerësimin e rrezikut të zjarrit dhe teknikat e luftimit

Kushtet e klasifikimit të rrezikut të luftimit të zjarrit (Australiane)	Lartësia e flakës (m)	Intensiteti (kw/m)	Kushtet e mundshme të shqopës	Teknikat e luftimit
I ulët	<0,5	0-50	E re/e rrallë	Zjarret zakonisht vetëshuhen.
I moderuar	0.5-1.5	50-500	E re/mbulesë e mirë Mbulesë e keqësuar/kufizuar	Sulm i drejtpërdrejtë me rrahës, sistemet ujë-bazuar
I lartë	1.5-3.0	500-2000	E rritur E pjekur Mbulesë e keqësuar/kufizuar	Sulm i drejtpërdrejtë i fuqishëm, sidomos me rrahës. Përdorni sistemet e ujit si reshje me rrahës. Bombardim uji me helikopter. Konsideroni sulm indirekt në kufijtë e sipërm (2000 kw).
Shumë i lartë	3.0-10.0	2000-4000	Faza e pjekurisë	Zjarret e shpejtë në shqopë: Sulm direkt nga bombardimet me helikopter me ujë. Sulm anësor dhe indirekt, d.m.th., ndërprerëset e zjarrit, e rekomanduar.
Ekstreme	> 10	4000 mund të tejkalojë 60000		Përpjekjet e Kontrollit ndoshta joefektive. Strategjia mbrojtëse rekomandohet.

10.6 **Aneksi 6 Aneksi 6 Modeli-tip për projekt për masat mbrojtëse nga zjarret**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU _____
BASHKIA _____
Nj. Administrative _____

MODELI-TIP PËR PROJEKT PËR MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRET

11.7.1.0.1 ***Fshati:*** _____
11.7.1.0.2 ***Zona kadastrale:*** _____
11.7.1.0.3 ***Emri popullor i vendit:*** _____
11.7.1.0.4 ***Ekonomia Pyjore/Kullosore:*** _____
11.7.1.0.5 ***Ngastra/Nënngastra:*** _____

PROJEKTUESI

_____

Miratohet

_____

(Miratimi nga struktura e pyjeve në bashki)

VITI _____

KAPITULLI I

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

- **Qëllimi:**

(Të përshkruhet në detaje qëllimi i kryerjes së ndërhyrjes).

- **Objektivat:**

(Të përcaktohen në detaje objektivat dhe detyrat që realizohen me anë të këtij investimi).

KAPITULLI II

TË DHËNA PËR OBJEKTIN

- **Shtrirja e masivit (objektit) ku do të kryhen punimet:**

(Si pozicioni gjeografik, bashkia, ekonomia pyjore/kullosore dhe ngastrat që përfshihen, pronësia... etj.).

- **Lartësia mbi nivelin e detit;**
- **Pjerrësia e terrenit;**
- **Erërat lokale dominuese:** (drejtimi, periudha, shpeshtësia... etj.).

MARRJA E TË DHËNAVE:

(Jepet informacion nga janë marrë të dhënat, dokumentacioni, institucioni etj.).

- **Informacion i shkurtër historik:**

(Jepen të dhëna për zjarret në këtë objekt, me synim evidentimin e shkaqeve dhe si orientim për masat që propozohen, punime të mëparshme për MNZ-në etj., apo punime silvikulturore, si rrallime apo krasitje etj.).

KAPITULLI III

PUNIMET QË DO TË KRYHEN

- **Masat parandaluese**

Përshkruani me detaje masat drejt komunitetit si masa më të rëndësishme për parandalimin e zjarreve duke qenë se zjarret janë shkaktuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor. Qëllimi i tyre është të parandalojnë rënien e zjarreve në pyje, si rezultat redukton numrin e zjarreve. Bazuar në këtë, ato janë masat më efektive për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe zbatimin e tyre mund ta ndajmë në:

- **Masa edukative** (përshkruani me detaje se cilat masa janë aplikuar deri në momentet e fundit... etj.).
- **Masa të fushatës së ndërgjegjësimit** (të përshkruara në detaje nëse aplikohen).

- **Masat përgatitore**

Përshkruani hollësisht masat përgatitore (si vëzhgimi dhe njoftimi, rekrutimin dhe trajnimin e zjarrfikësit (zjarrfikës vullnetar), planin vjetor për mbrojtjen kundër zjarreve... etj. Këto masa duhet të merren gjatë gjithë vitit. Ndërsa masat parandaluese synojnë parandalimin ose reduktimin e numrit të zjarreve në pyje, masat përgatitore na mundësojnë që të përballemi me zjarret e pyjeve në mënyrë të organizuar.

TEKNIKA QË DO TË ZBATOHET KUR NDËRTOHEN BREZAT MBROJTËS:

- ✓ Përshkruhet me hollësi teknika e punimeve që do të kryhen, gjerësia e brezave të cilat këshillohen të ndërtohen në objektin ku do të kryhet ndërhyrja; orientimi i tyre lidhur me erërat lokale; me pjerrësinë e terrenit me llojin e bimësisë drunore... etj.;
- ✓ punimet që propozohen për llojet halorë, fletorë trungishte;
- ✓ punimet që propozohen për llojet cungishte;
- ✓ punimet që propozohen për shkurret;
- ✓ punimet që propozohen për sipërfaqet e kullotave dhe livadheve.

Për secilën formë qeverisjeje të jepen në detaje:

punimet që do të kryhen, gjerësia e brezit, teknikat dhe pajisjet që do të përdoren... etj.

Përshkruani në detaje rrezikun e shfaqjes së zjarrit bazuar në aspektin historik, karakteristikat e lëndës djegëse, kushtet e motit... etj.

KAPITULLI IV

- **Grafiku i punimeve** (flitet gjerësisht për çdo aktivitet më vete, për kohën e fillimit dhe mbarimit).
- **Shpenzimet për realizimin e projektit.**

Vlerësimi i buxhetit	_____ lekë kërkuar _____lekë financuar

Efektiviteti i ndërhyrjes (shpenzime, të ardhura dhe bilanci i aktivitetit).

- **Kuotimi për bazën materiale** (shpjegohet me detaje rreth çmimit të referencës).
- **Analiza e riskut** (të analizohen vështirësitë që mund të hasen në arritjen e objektivit).

KAPITULLI IV

- **Profili i objektit.**
- **Foto të objektit.**
- **Profili i objektit me elementet përkatëse** të dimensionuar**a me shkallën përkatëse.**
- **Harta e objektit dhe skica e vendosjes së brezave**.
- **Foto digjitale** të vendit ku do të ndërhyhet.
- **Harta e ngastrës e gjeoreferuar** me koordinatat në KRGJSH të pikave të thyerjes së poligonit të objektit dhe ndarjet pyjore/kullosore ku do të ndërhyhet.

PREVENTIV PËR MASAT MBROJTËSE KUNDRA ZJARRIT

(me metodat mekanike, kimike, me biopreparate dhe biologjike)

Emri i objektit: _____
Ekonomia Pyjore/Kullosore: _____
Nr. i parcelës/nënparcelës: _____
Sipërfaqja: _____(Jepet sipërfaqja ku do të ndërhyhet)
Volumi i punës: _____

Nr.	Shenja e manualit	Emërtimi i punimeve	Njësia	Volumi	Çmimi	Vlefta
	Shuma I					
	Shpenzime transporti, bazë materiale					
	Shuma II					
	Shpenzime administrative					
	Kostoja e projektuesit					
	Kostoja e drejtuesit teknik					
	Shuma III					
	Tatimi në burim					
	Totali					

PREVENTIVUES
Ing. _____

10.7 Aneksi 7 Si të vendosni alarmin e zjarrit në e-mailin tuaj (nga NASA)

1. Shko në faqen e mëposhtme:
https://earthdata.nasa.gov/earth-observation-data/near-real-time/firms/active-fire-data.



2. Shko në fund të faqes ku shkruhet *Firms* dhe zgjidh opsionin *"File e-mail alerts"*.



3. Do të shfaqet një web faqe si më poshtë:

4. Vendos adresën e e-mail-it dhe kliko *Proceed.*



5. Do të shfaqet një pamje si më poshtë:

6. Këtu zgjidh *"Create Fire Alert"*.

- Tregoni një emër për alarmin e zjarrit;
- Më pas zona duke zgjedhur *"Country"*;
- Pastaj:
  - shtetin - Albania, këtu është mundësia për të vënë një polygon që të intereson vetëm për atë pjesë;
  - rrezen në km;
- në fund përzgjidhni 3 kutitë e *"Fire Source"*.